



Dosja e plotë

► F 10

ISMAILAJ, SKEMA E PASTRIMIT TE 3 MILIONE USD NE VITIN 2006

Masakra në Tiranë

► F 12-13

Familjarët e vajzës:
Nuk merrej me drogë,
babai i punonte roje



Arkeologji

► F 20-21

ZBULOHET TEMPULLI I SHEK. III NE VLORE

Intervista, flet arkeologu Muçaj:
Në themelet e kishës së shek. IX

[SHQIPTARJA.com]



ÇMIMI 30 LEKË

VITI V - NR. 234


ESHTUNË, 03-10-2015

www.shqiptarja.com

ZBULOHET LIGJI HIQEN PAGAT E KESHILLTAREVE BASHKIAKE

Zbardhet projekti i ri i Qeverisë për Pushtetin Vendor. Nuk do të ketë kryetarë bashkie me më shumë se dy mandate. S'do lejohen në bashki të afërm, madje as vjehrra me nusen apo me dhëndrin

► FAQE 2-3



PROCEDURAT E PLOTA

► F 9

LOTARIA AMERIKANE, JA SI DO TE BEHET PERZGJEDHJA, KU S'DUHET TE GABONI

Departamenti i Shtetit publikon rregullat. Pas aplikimit duhet konfirmuar emri. Fituesit do njoftohen vetëm nëpërmjet kodit. Procedurat që ndiqen

BMC Blue Medical Center
Vizita, Analiza & Diagnostikim
Të garantuara sipas protokolleve të mjekësisë bashkëkohore nga Blue Medical Center

Të parandalosh, më mirë se të kurosh!

Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë
Tel: + 355 4 2370 668

Cel: +355 66 20 90 008
Email: info@bmc.al, www.bmc.al

NISMA E RE RREGULLA TE REJA PER MEKANIKET DHE SERVISET

Nuk do të lejohen shërbime për automjetet pa u certifikuar

► F 7



INTERVISTA DORINA E "SPIRIT VOICE", VENDOS TE KTHEHET NE SHQIPERI

"Do të bashkëpunoj me
Rozana Radin dhe Jurgen Shirën"

► F 24

Zbardhet drafti, këshilltarët e bashkive pa paga

Nuk lejohen 2 këshilltarë nga një familje, as vjehrra a vjehrra me nusen a dhëndrin

ESIONA KONOMI
TIRANE

Këshilltarët e këshillave bashkiakë nuk do të paguhen më për pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e këshillit sikundërse ndodhte deri më tani. Ministria për Çështjet Vendore, në bashkëpunim me USAID-in kanë gati projektligjin e ri "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", draft i cili do të hidhet për konsultim publik dhe pritet të miratohet nga qeveria në fund të tetorit. Në fund të dhjetorit pritet të miratohet në parlament, me ndryshimet përkatëse. Sipas këtij drafti, këshilltarët nuk do të paguhen sikundërse deri më tani, që merrnin shpërblym mujor në masën 10 % të pagës së kryebashkiakut. Projektligji sjell një ndryshim në funksion e këshilltarit bashkiak, ku parashikohet që funksioni i këshilltarit të jetë një funksion pa shpërblym, por nga buxheti i bashkisë mund ti rimbursohen shpenzimet e kryera për pjesëmarrjen në mbledhje (psh. shpenzimet e udhëtimit). "Ky ndryshim është në përputhje me përcaktimet e Kartës Evropiane të Qeverisjes Vendore e cila evokon funksionin qytetar dhe komunitar të këshilltarëve si përfaqësues të një kauze publike dhe jo si "funksionar publik" që kryen funksionet kundrejt një shpërblymi për punë", thuhet në relacionin



Kriteret

PAGESA

Parashikohet që këshilltari të jetë një funksion pa shpërblym, por nga buxheti i bashkisë mund ti rimbursohen shpenzimet e kryera për pjesëmarrjen në mbledhje, si shpenzimet e udhëtimit.

PAPAJTUESHMËRIA

"Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehrra a vjehrra me nusen dhe dhëndrin", thuhet në projektligj.

shoqërues të këtij projektligji. Më tej Ministria për Çështjet Vendore, shpjegon se "ndryshimet e sjella në projektligj i japin një rol më të madh këshillit për monitorimin dhe kontrollin ndaj ecurisë dhe



performancës së ekzekutivit në raport me vendimet e këshillit dhe pritshmëritë të qytetarëve. Këshilli në rolin e tij të ri, vendoset në rolin e duhur si organ përfaqësues i interesave të komunitetit". Një tjetër kufizim vihet për marrëdhëniet familjare mes këshilltarëve. "Gjithashtu sanksionimi në projektligj që këshilltarët janë subjekt i legjislacionit për konfliktin e interesave garanton rritjen e përgjegjshmërisë së këshilltarëve në kryerjen e funksionit të tyre dhe parandalimin e fenomeneve korruptive të hasura shpesh në vendimmarrjet e këshilltarëve bashkiak", thuhet në relacion. Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me: a) funksionin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bashkisë; b) funksionin e sekretarit të këshillit bashkiak; c) funksionin e nëpunësit të administratës

së bashkisë përkatëse dhe institucioneve në varësi të saj; ç) funksionin e deputetit. "Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një këshill bashkiak. Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe

vjehrra e vjehrra me nusen dhe dhëndrin", thuhet në projektligjin e përgatitur. Projektligji synon miratimin e një ligji organik të qeverisjes vendore i cili do të vendosë kuadrin e ri normativ për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore duke njohur funksionet dhe kompetencat e reja që

i decentralizohen qeverisjes vendore si dhe organizimit dhe funksionimit sa më të mirë, pas reformës së thellë administrativo-territoriale. Projektligji parashikon një tipologji të re të funksioneve të qeverisjes vendore duke i klasifikuar ato në funksione të veta dhe funksione të del-

RAPORTI/ NUMRI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK, SIPAS POPULLSISË


Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë si më poshtë:

■ Bashkitë deri në 20 000 banorë	15 anëtarë;
■ Bashkitë nga 20 001 deri në 50 000 banorë	21 anëtarë;
■ Bashkitë nga 50 001 deri në 100 000 banorë	31 anëtarë;
■ Bashkitë nga 100 001 deri në 200 000 banorë	41 anëtarë;
■ Bashkitë nga 200 001 deri në 400 000 banorë	51 anëtarë;
■ Bashkitë mbi 400 000 banorë	61 anëtarë

NENI 20/ SHTOHET E DREJTA E INICIATIVËS QYTETARE


Banorët mund të propozojnë vetë akte ligjore për bashkinë e tyre

Projektligji i Ministrisë për Çështjet Vendore sjell një risi si a i takon përfshirjes direkte të qytetarëve në vendimmarrje. Përmes 3 nenëve specifike, drafti parashikon që qytetarët të ndërmarrin nisma ligjore për bashkinë e tyre dhe t'i japin propozime ato këshillave bashkiakë. "Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshill iniciativë qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së qeverisjes vendore", thuhet në projektligj. Propozimet e ardhura



në këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore, shqyrton në këshill sipas rendit të ditës dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë miratimin e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore. Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'i drejtojnë peticione, ankesa apo kërkesa organeve të qeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së qeverisjes vendore. Organet e qeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim

peticionet, ankesat apo kërkesat dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj. Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.



Kryetarët e bashkive jo më shumë se dy mandate radhazi

Vendoset kufizimi i të drejtës për rizgjedhje, mund të garosh vetëm pas qëndrimit një mandat në "stol" për katër vite

ESIONA KONOMI
TIRANE

Kryetarët e bashkive nuk do të mund të zgjidhen për më shumë se dy mandate radhazi. Projektligji i ri "Për organizimin dhe funksionimin e pushteteve vendore" kufizon këtë mundësi, duke bërë që pas dy mandatesh, kryetari i bashkisë nuk mund të zgjidhet më shumë se dy herë, pa bërë të paktën një mandat "pushim". Më pas mund të rizgjidhet përsëri, duke respektuar gjithmonë detyrimin për ndërprerje midis 8 vjetësh. "Projektligji sanksionon për herë të parë "kufizimin e mandatit" për kryetarët e bashkive në vetëm dy mandate radhazi. Ezaurimi i

dy mandateve radhazi nuk do mund të lejojë rikandidimin për mandatin e tretë radhazi, por lejohet rikandidimi vetëm pas kalimit të një mandati në "stol". Ky mekanizëm në kushtet e një demokracie akoma jo funksionale në

Shqipëri, garanton konkurrencë dhe hapje të garës për kandidatura të reja dhe alternative dhe përmirësim të qeverisjes demokratike në nivel lokal", thuhet në relacionin që shoqëron projektligjin. Drafti forcon rolin e

kryetarit të bashkisë si organ ekzekutiv duke i dhënë kompetenca të qarta në drejtim të administrimit dhe organizimit të strukturave të bashkisë, të njësive administrative dhe ndërmarrjeve në varësi, por gjithashtu edhe në drejtim të

përfaqësimit juridik në raport me të tretët, veçanërisht në raport me shoqëritë tregtare me kapital të bashkisë, çështje që ka qenë problematike në vitet e kaluara. "Projektligji vendos bazat juridike për një kapërcim cilësor dhe të qenësishëm në qeverisjen me pjesëmarrjen e komunitetit. Projektligji krijon për herë të parë strukturat komunitare në qytete, në formën e këshillave komunitarë të lagjeve dhe mekanizmin e ndërlidhës komunitar, duke plotësuar kështu një vakum që kishte në hapësirën urbane në raport me fshatin ku ligji i vjetër e parashikonte strukturën e kryetarit të fshatit dhe kryesisë. Qeverisja komunitare është një qasje e re në politikë lokale në Shqipëri sidomos në pjesët urbane dhe sanksionimi me ligj i kësaj strukture do të japi hov nis-mave qytetare për gjallërimin e jetës në komunitet dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në punët e bashkisë", thuhet në relacionin drejtuar qeverisë. Projektligji për herë të parë fut konceptin e "decentralizimit asimetrik" të funksioneve dhe kompetencave. Ky instrument është përdorur në praktikën e transferimit të funksioneve dhe kompetencave por nuk ka qenë pjesë e specifikuar në ligjin organik aktual. Njohja me ligj i këtij instrumenti lejon decentralizimin e funksioneve dhe kompetencave në mënyrë të diferencuar duke ja përshtatur transferimin e funksioneve aftësitë reale që kanë njësi vendore të ndryshme. Projektligji sjell një klasifikim të ri të kompetencës së njësive të qeverisjes vendore në kryerjen e funksioneve. Ato klasifikohen në kompetenca për të "administruar" dhe për të "rregulluar" funksionet që njeh ligji. Kompetenca e njësive vendore për "të administruar" funksionin përkufizohet në projektligj si e drejta për të planifikuar, financuar dhe organizuar ushtrimin e funksionit. Ndërsa kompetenca për të "rregulluar" është e drejta për të përcaktuar rregulla të përgjithshme dhe abstrakte sjelljeje si dhe standarde të detyrueshme në përputhje me ligjin. Ky formulim i kompetencave në ushtrimin e funksioneve e bën më të thjeshtë nga pikëpamja juridike shpjegimin se deri ku shtrihet autoriteti apo juridiksioni për të kryer një funksion, gjë e cila ka qenë problematike me klasifikimin aktual të kompetencave.



Transparenca

LLOJSHMËRIA
Projektligji i ka shtuar parimin e shumëllojshmërisë në kryerjen e shërbimeve duke filluar nga kryerja nëpërmjet strukturave të brendshme të vetë bashkisë deri tek partneriteti publik-privat.

PERFORMANCA

Ligji cakton që në fushën e shërbimeve publike, bashkia është e detyruar të hartojë standarde të funksioneve dhe performancës për secilin nga shërbimet publike dhe ka detyrimin të monitorojë ato.

LLOGARIDHËNIA

Qeverisja vendore do të jetë e detyruar të ndjekë rregulla të qarta dhe transparente për shërbimet publike që financohen nga tarifat e qytetarëve dhe që do të nxisë llogaridhënien para publikut dhe qytetarëve.

DRAFTI/ VENDORËT PËRGJEGJËSI PËR SIGURINË PUBLIKE

Decentralizimi, bashkitë marrin 41 kompetenca në 7 sektorë

Bashkitë e reja do të kenë gjithsej 41 kompetenca, të shpërndara në 7 sektorë, shumica e të cilave janë risi: në sektorin e bujqësisë, kullimit, pyjeve, arsimit, sigurisë publike dhe zjarrfikësit. Kështu, ë fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse për 14 shërbime, mes të cilëve: Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm; Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura; Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara; Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe shesheve publike vendore; Ndriçimi i mjediseve publike; Transportin publik vendor; Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; etj. Bashkitë do të kenë 4 funksione në fushën e shërbimeve sociale, si: Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtetas në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me



ligj. Gjithashtu, e në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve rekreative bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e katër funksioneve. Bashkitë u shtohen kompetenca në fushën e mbrojtjes së mjedisit, dhe në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave. Mes tyre dallohet krijimi dhe administrimi i skemave vendore

të granteve për bujqësinë dhe zhvillimit rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët. Në fushën e zhvillimit ekonomik lokal bashkitë kanë 6 kompetenca, mes tyre dhe dhënen e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm.

SIGURIA

Shkrihet policia bashkiake, konfliktet zgjidhen në komunitet



Me shkrirjen e policisë bashkiake, vendorët marrin rolin e negociatorit për mosmarrëveshjet komunitare. Bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve: Garantinë e mbarrëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet; Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregullores dhe akteve të njësive të qeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

Kryeministri Edi Rama mbajti fjalim në Asamblesë të Përgjithshme të OKB-së në Nju-Jork. Ai u kërkoi vendeve anëtare që nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës ta bëjnë këtë gjë pasi i shërben paqes në Ballkan. Kryeministri i Shqipërisë tha se viti që lamë pas ishte i pari ku nuk pati konflikt të armatosur mes vendeve të rajonit në Ballkan. Sipas tij në rajonin e Ballkanit tani guxohet më në fund të shikohet e ardhmja me shpresë dhe të tregohet se një tjetër mënyrë për të shkruar para është e mundur. "Për herë të parë vitin e kaluar, pas 100 vitesh konfliktesh e konfrontimesh të ngjira ose aktive në Ballkan, armët nuk u drejtuan më kundër asnjë dritareje fqinji. Pas një shekulli të shënjuar nga konflikti, më në fund patëm një vit bashkëpunimi për ta bërë paqen e arritur, një paqe të denjë për t'u jetuar. Bisedimet mes Serbisë e Kosovës, një shtet i ri që kontribuon për stabilitetin në rajon, kanë bërë të mundur që të dy vendet të gjejnë zgjidhje të përbashkëta për një sërë çështjesh dhe për të mirën e popujve të tyre", deklaroi Rama. Në këtë kuadër tha kryeministri, njohja e pavarësisë së Kosovës do të shtynte më tej procesin e paqes në të cilën ka hyrë Ballkani. "Dhe më lejoni t'ju bëj thirrje këtu, të gjithë atyre midis jush që ende nuk e kanë njohur Kosovën, për ta bërë këtë. Duke e njohur Kosovën japin një kontribut të drejtëpërdrejtë për forcimin e stabilitetit, paqes e bashkëpunimit në një rajon që vitin e kaluar u shndërrua në

Vlerat
"Parimet dhe vlerat e tolerancës, shkruar e zeza mbi të bardhë në një Kartë Globale, nuk mund të fshijnë ekstremizmin e dhunshëm, stereotipet, diskriminimin e plagët që kanë shkaktuar".



Kryeministri Edi Rama duke folur në OKB

Botimi
Fjalimi i kryeministrit shqiptar Edi Rama është botuar nga prestigjiozja Financial Time si editorial me titullin "Për të mposhtur terrorizmin nevojiten të dyja, dialogu dhe forca".

Rama, në OKB: Njihni pavarësinë e Kosovës

Kryeministri: Kartë globale për arsimin e të rinjve, që në të ardhmen të ketë më shumë tolerancë

një histori të rëndësishme suksesi i shpresave dhe ëndrrave të së ardhmes, që mbizotërojnë mbi frikën dhe ankthet e së kaluarës. Njohja e plotë e Kosovës nga të gjitha kombet e kësaj Asambleje do të jetë diçka e mirë edhe për Serbinë", tha Rama. Ai tha se vitin e kaluar ishte i pari Kryeministër shqiptar që vizitoi Beogradin, pas 68 vjetësh. "Nga Samiti i Vjenës për Ballkanin në gusht 2015, rajoni është duke zhvilluar me sukses një sërë



bashkëpunimesh, përfshirë atë në fushën e shkëmbimeve rinore, të promovuar nga Shqipëria e Serbia, të frymëzuar nga modeli i shkëmbimeve rinore mes Francës e Gjermanisë pas Luftës së Dytë Botërore", tha Rama. Pasi foli për konfliktet fetare e përplasjet e qytetërit, ai krijimin e një karte globale për arsimin e të rinjve, që në të ardhmen të ketë më shumë tolerancë. "Ne jemi duke u përqendruar tek kjo në mënyrë në veçanti,

sepse është thelbësore për t'i edukuar të rinjtë tanë atë çfarë historia na ka mësuar: Është më mirë të vlerësojmë dallimet tona dhe jo t'i luftojmë ato; të mësojnë nga e kaluara jonë jo dhe jo të jetojmë në të, pavarësisht vendit, gjuhës, ngjyrës, fesë dhe besimit. Këto vlera të shprehura në fjalë, që duhet të mësohen dhe edukohen në shkollë, mund të jenë ura të qëndrueshme që lidhin zemrat dhe mendjet në një veprim të përbashkët dhe botën tonë për një të ardhme më të mirë. Garancia më e mirë për një të ardhme më të mirë janë zemrat dhe mendjet e të rinjve tanë. Nëse do u tregojmë atyre rrugën e drejtë, ata do të ecin në të", tha Rama duke shtuar se Shqipëria do të përfshijë një kartë të tillë në sistemin e saj arsimor. Ai ka përsëritur se përpara se të bëjë politikan ka qenë artist dhe se i pëlqen të pikturojë. "Të gjithë jemi duke u përpjekur të pikturojmë tablonë tonë të madhe, me mënyrat tona të ndryshme, të përcaktojmë një vizion të qartë dhe të punojmë në atë drejtim. Nëse bota do ishte një pikturë, sot ajo do ishte më shumë gri sesa bardhë e zi. Ka pak gjëra të sigurta e ato do kishte shumë penelata të ndritshme e të forta ngjyrash që paralajmërojnë për shumë rreziqe, shumë kërcënime. Por këtu, në këtë vend, ka vlera dhe parime që mund të vlejnë për të gjitha sfidat me të cilat përballemi në botë dhe ne kemi nevojë për ato vlera e parime tani më shumë se kurrë", tha Rama. Për të cilin vlerat e parimet e tolerancës, respektit për diversitetin e feve, identiteteve, kulturave etj janë primare.

LAJME SHKURT



Talasemikët, Gaiani prezanton projektin italian në Lushnjë

Një projekt Italian për pacientët talasemikë do të fillojë zbatimin në spitalin e Lushnjës. Ky qytet do të përfitojë asistencë mjekësore dhe pajisje për të sëmurrët talasemikë nga kjo iniciativë. "Besoj se kjo është një fushë e rëndësishme dhe me një potencial të madh bashkëpunimi. Kemi edhe një konfigurim ideal, sepse kemi një personel që po ndihmohet edhe nga zyra italiane për zhvillim", tha ambasadori Italian, Massimo Gaiani. Kryebashkiaku Fatos Tushe i dhuroi ambasadorit Gaiani simbolin e qytetit, atë të kongresit të Lushnjës dhe një album për historinë e këtij kongresi.

Ditmir Bushati, takim me homologun e Egjiptit dhe Kubës

Në kuadër të qëndrimit të tij në Nju Jork, për të marrë pjesë në Punimet e Sesionit të 70 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Ministri i jashtëm, Ditmir Bushati zhvilloi takime me homologun e Egjiptit, Sameh Shoukry dhe të Kubës, Bruno Eduardo Rodríguez Parrilla. Gjatë takimit të zhvilluar me Ministrin e Punëve të Jashtme të Egjiptit, Sameh Shoukry, dy ministrat vunë në dukje marrëdhëniet shumë të mira që ekzistojnë midis dy vendeve tona dhe shprehën vullnetin për avancimin e mëtejshëm të tyre, sidomos në aspektin ekonomik.



Di 09.10.2015 ora 16:00

STUDIO PËRMBARTIMORE GJYQËSORE "KREON" ME PËRMBARUESE GJYQËSORE JOANA KONOMI

(Për First Investment Bank sh.a)

PËRFUNDON ANKANDI I PARË PËR PASURINË:

Pasuria "Apartament" me sip. 56.45 m2, me Nr pasurie 5/266+2-5, zonë kadastrale Nr.8130, vol.13, fq.247 me adresë Rr. "Bajram Curri", Tiranë me çmim 22580 euro

ANKANDI ZHVILLUOHET NË ZYRËN E STUDIO PËRMBARTIMORE GJYQËSORE "KREON", ME ADRESË Rr."G.Ë.BUSHI", URË E TABAKEVE, P64, KATI-2 TIRANË, KONTAKT CEL 0682096575



Naço në takimin e përvitshëm të drejtësisë në Londër

Ministri i Drejtësisë, Nasip Naço, me ftesë të homologut të tij britanik, ka marrë pjesë në ceremoninë e hapjes së vitit ligjor për Anglinë dhe Uellsin. Naço zhvilloi një takim me kryetarin e Gjykatës Supreme të Mbretërisë së Bashkuar, të cilin, sipas një njoftimi nga Ministria e Drejtësisë, e informoi "mbi situatën aktuale të sistemit gjyqësor në Shqipëri, mbi problematikat që ajo shfaq, si dhe e njohu atë me reformat e ndërmara nga qeveria dhe Parlamentit Shqiptar, duke filluar me ndryshimet kushtetuese që do të mundësojnë mirëfunksionimin e institucioneve të gjyqësorit".

I sekuestrohet malli, rrobaqepësi tenton t'u verë flakën copave



Tatimorët kanë hasur në rezistencën e familjarëve të një rrobaqepësi, teksa kanë shkuar për të sekuestruar mall pa faturë në një rrobaqepësi në Fier. Policia tatimore gjeti një sasi malli pa faturë në rrobaqepësinë e Pandeli Toles. Sipas rrobaqepësit, një pjesë e mallit pa faturë, do të deklarohet si mall pa faturë dhe do pajisje me fatura, e në qoftë se jo, do të largonte nga rrobaqepësia. Tole ka këmbëngulur se po vijon procedurën siç e parashikon ligji deri në fund të dhjetorit. Por, kur pa se tatimorët kanë bërë dokumentacionin për sekuestrim, ka tentuar të djegë mallin

ISIS kërcënon kryeministrat e Ballkanit, mes tyre Rama e Mustafa

Një mesazh ka mbërritur në adresat e disa mediave ballkanike, që përmban një kërcënim për gjithë kryeministrat e rajonit. Një militant i Shtetit Islamik, i quajtur Abu Turab, ka dërguar foto të kryeministrave të rajonit të "pëpirë" nga flakët. Sipas militantit të ISIS, shumë shpejt do nisn

sulmet në Ballkan. "Do ishte mirë që këta kryeministra të ruajnë veten. Kalifati po vjen në Ballkan dhe aty kemi plot vëllezër të etur për gjak. I themi gjithashtu Putin që të na sjellë ushtarë dhe do ia kthejmë mbrapsht kokat e tyre", thuhet në mesazhin e Abu Turab.

Krichbaum: "Dekriminalizimi, kusht i parësor për negociatat"


Shqipëria është shumë larg fillimit të bisedimeve, raporti i ODIHR, shqetësues

LEONARD QUKU
TIRANË

Deputeti gjerman dhe kreu i Komisionit për Çështjet Europiane në Bundestag, Gunther Krichbaum, shprehet gjatë një interviste për "Deutsche Welle" se Shqipëria është shumë larg çeljes së negociatave të anëtarësimit me BE. Shqetësim për gjermanët përbën raporti i ODIHR për zgjedhjet e 21 qershorit dhe procesi i dekriminalizimit. "Aktualisht Shqipëria, jo vetëm për shkak të parregullsive në zgjedhjet e fundit lokale, ndodhet ende shumë larg fillimit të bisedimeve të anëtarësimit për në BE. Por më lejoni të them hapur diçka lidhur me zgjedhjet lokale: Ato çfarë raportohen mbi zgjedhjet nga ODIHR-i, qen-

MINISTRJA E INTEGRIMIT

Klajda Gjoshë: Po shkojmë drejt çeljes së negociatave



Ministrja e Integrimit Europian, Klajda Gjoshë u shpreh se Shqipëria po ecën drejt çeljes së negociatave të anëtarësimit me BE-në. Gjatë një takimi me Drejtorin e Departamentit për Ballkanin Perëndimor dhe Zgjerimin, në Ministrinë e Jashtme të Britanisë së Madhe, Graham Styles, Gjoshë tha se mbarëvajtja e procesit të integrimit është një prioritet kombëtar, jo vetëm i qeverisë por i gjithë shoqërisë shqiptare. "Jemi të angazhuar maksimalisht për reformën në drejtësi, e cila është e domosdoshme për të kaluar në fazën e radhës që është hapja e negociatave. Ne jemi të bindur se implementimi i saj do të ishte shumë me efektivi, përmes kapitujve 23 dhe 24, me të cilët ne dëshirojmë të hapim negociatat", tha ajo.



Gunther Krichbaum

dra e zgjedhjeve të OSBE-së, janë për një vend që aspiron të bëhet anëtar i Bashkimit Europian tërësisht të papranueshme", u shpreh kreu i Komisionit për Çështjet Europiane në Bundestag, Gunther Krichbaum. Pavarësisht skepticizmit të Berlinit, Krichbaum thekson se komisioni që ai drejton do të ndjekë me shumë vëmendje sa janë realizuar reformat, siç është lufta kundër korrupsionit, reforma në sistemin e drejtësisë, zgjedhjet e lira dhe të ndershme si dhe procesi i dekriminalizimit. Madje, për këtë të fundit, zyrtari i lartë i Bundestagut gjerman thotë se do të jetë elementi kyç për ecjen përpara me procesin e integrimit europian të vendit. Sipas tij, prej dekriminalizimit të politikës do të varret edhe çelja e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në

BE. "Për ne është një kusht i panegociueshëm për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit që politika shqiptare të dekriminalizohet", tha ai. Teksa vlerëson propozimet e PD, kryetari i Komisionit për Çështjet

NEGOCIATAT

"Aktualisht Shqipëria, jo vetëm për shkak të parregullsive në zgjedhjet e fundit lokale, ndodhet ende shumë larg çeljes së negociatave BE. Ato çka raportohen për zgjedhjet, janë të papranueshme"

"DEKRIMINALIZIMI"

"Për ne është një kusht i panegociueshëm për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit që politika shqiptare të dekriminalizohet. Unë shpresoj shumë që më në fund të kemi ujdinë mes qeverisë dhe opozitës"

"Ato çfarë raportohen mbi zgjedhjet nga ODIHR-i, qendra e zgjedhjeve të OSBE-së, janë për një vend që aspiron të bëhet anëtar i Bashkimit Europian tërësisht të papranueshme"

Europiane në Bundestag, Gunther Krichbaum inkurajon klasën politike shqiptare që të miratojnë me konsensus ligjin për dekriminalizimin. "Në këtë pikë Partia Demokratike ka bërë propozime të mira dhe unë shpresoj shumë që më në fund të kemi ujdinë

mes qeverisë dhe opozitës", theksoi më tej ai. Skandali i CEZ, për Krichbaum duhet të hetohet prokurorë ndërkombëtarë, kjo për të rritur besueshmërinë dhe rezultatet e hetimit. "Duke pasur parasysh situatën e ndezur politike në Shqipëri, unë e shoh si një propozim shumë të mirë pjesëmarrjen e hetuesve ndërkombëtarë për zbardhjen e kësaj afere. Kjo sigurisht do të rriste besueshmërinë dhe pranueshmërinë e rezultateve të hetimit", shtoi ai. Deputeti gjerman dhe kreu i Komisionit për Çështjet Europiane në Bundestag, Gunther Krichbaum flet edhe për vizitën e kreu të PD, Lulzim Basha në Berlin.

LAJME SHKURT



"Integrimi i Ballkanit do të parandalonte konfliktet në rajon"

Ministrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli dhe një grup i ekspertëve për pjesëmarrësit në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Gjatë fjalës së saj, ministrja tha ndër të tjera se integrimi i Ballkanit në BE do të parandalonte konfliktet në rajon. Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes është Kursi më i lartë në piramidën e arsimit ushtarak në FA-të e Shqipërisë. Aty marrin pjesë ushtarakë të lartë nga FA-të e Shqipërisë, Kosovës, Gjermanisë, Italisë, Turqisë, Greqisë, Gjeorgjisë, Maqedonisë, si dhe përfaqësues nga institucione në vartësi të Ministrisë së Brendshme, asaj të Drejtësisë, nga Presidencia, etj.

Shkodër, Drejtoritë s'kanë mjete për të përballuar përmbytjet

Shtabi i ri i emergjencave civile u prezantua në qytetin e Shkodrës në bazë të reformës së re territoriale. Gjatë takimit, pati disa diskutime për çështjen e përmbytjeve. Shumë drejtues të drejtorive u shprehën se kanë shumë probleme sa i përket kapaciteteve me mjete apo logjistike.



Drejtori i bordit të kullimit Arditi Hotaj tha se ministria nuk financon të gjitha projektet, ndërsa, drejtori i repartit të zjarrfikësve, Zamir Sylja foli për amortizimin e mjeteve, mungesën e fondeve apo mungesën e hidrantëve në rrugët e qytetit.

STUDIO PËRMBARIMORE "SPEED SOLUTION" NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 1 PËR:

"Apartament", me sipërfaqe 49.92 m², me nr.pasurie 4/97+1-8, Z.k.8621, Vol.5, Faqe112 me adresë Lagjainr.4, Pall.13/1, Shk.1, Kati.3, Ap.8, Krujë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të RAIFFEISEN BANK sh.a. **Çmimi me të cilin fillon ankandi është 1,680,000 (një milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë**

Ankandi do të zhvillohet më datë **07.10.2015, Ora 16:00**, pranë Studios Përmbarimore "SPEED SOLUTION" me Adresë: Bulevardi "Gjergj FISHTA" Kulla.1, Kati.2, Nr.3, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni
cel.0693041355, 0696334695 email: speed.solution@yahoo.com



PD, Stafa: Vangjush Dako masakroi administratën

Kryetari i Partisë Demokratike në Durrës, Osman Stafa, ia ka faturuar kryebashkiakut Vangjush Dako, përgjegjësinë për pushimet nga puna në administratë. "Shkopi mbajtës i Ed dramës, Vangjush Dako këtë javë kreu masakër ndaj administratës dhe punonjësve të ish bashkive dhe komunave në Durrës", shkruan Stafa në Facebook. "Në bashkin Sukth janë hequr 78 punonjës nga 86 që ishin. Në bashkin Manez janë hequr 38 punonjës nga 45 që ishin. Në komunën e Katund i Ri janë hequr 20 punonjës nga 23 që ishin", shton ai. Stafa ka ftuar qytetarët, "të denoncojnë çdo rast të shkakit të padrejtë nga detyra".

Betohen 10 gjyqtarë të rinj, Nishani: Kthehuni në shembuj



Këshilli i Lartë i Drejtësisë zhvilloi dje mbledhjen plenare, e cila nisi me ceremoninë e betimit të 10 magistratëve të dekretuar nga Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, në detyrën e gjyqtarit, pas propozimit të bërë nga KLD. Presidenti Nishani inkurajoi gjyqtarët e rinj që të jenë shembull për sistemin e drejtësisë. Dhjetë gjyqtarë të rinj janë Nurdeta Tafa, Enkelelda Kapedani, Ejona Lazellari, Elsa Ulliri, Atalanta Zeqiraj, Aurel Arapi, Flojera Davidhi, Genti Dokollari, Sokol Pina dhe Arben Dosti.

"Në 2016, OJF-të do zbatojnë standardet kombëtare të kontabilitetit"

Organizatat jofitimprurëse do të kenë standardet e tyre të raportimit të aktivitetit. Ky është urdhri i Ministrisë të Financave, botuar në fletoren zyrtare. Përmes këtij urdhëri, Standardi Kombëtar i Kontabilitetit të OJF-ve bëhet i detyrueshëm për zbatim prej datës 1

janar 2016. Deri në datën e zbatimit, me përdoruesit e tyre, duhet të organizohen seminare dhe trajnime në nivel kombëtar dhe lokal. Ky standard përshkruan objektin e pasqyrave financiare të OJF-ve dhe cilësitë që e bëjnë informacionin e pasqyrave financiare të OJF-ve të dobishëm.

Turi

LEONARD QUKU
TIRANE

Basha nis nga Lushnja dëgjesat me qytetarët

PD mbledh sot kryesinë, do vendoset për analizën, riorganizim strukturave

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha nis javën e ardhshme nga qyteti i Lushnjes turin e dëgjesave me qytetarët, sipërmarrës të fermerët, për të dëgjuar shqetësimet e tyre dhe parashtruar alternativën e opozitës për daljen e vendit nga kriza. Kjo duket se do të jetë lëvizja e radhës e kryetarit Basha, me kryefjalë, sipas opozitës, problemet ekonomike që po kalon vendi, me rritjen e papunësisë, rëndimin e barrës fiskale për biznesin apo dhe për masat shtrënguese kundër informalitetit. Burime pranë PD deklaruan për "Shqiptarja.com" se turi i Bashës do të nisë nga Lushnja dhe do të shtrihet në të gjithë vendin. Kryetari i degës së PD në Lushnjë, Myslim Murriçi konfirmon nisjen e protestave të Partisë Demokratike nga ky qytet. Ai ka paralajmëruar një takim të kryetarit demokrat Lulzim Basha me qytetarët të Lushnjes, biznesmenë dhe fermerë. "Ditën e martë me datë 6 tetor 2015 ora 10 në sheshin para bashkisë Lushnje dega e PD Lushnje organizon një tubim me qytetarë, biznesmenë, fermerë dhe do të interesuar për



TAKIMET

Kryetari i PD, Lulzim Basha nis javën e ardhshme takimet me qytetarët, në funksion të një turi dëgjesash për problemet ekonomike dhe sociale si dhe do të paraqesë platformën ekonomike të PD

ANALIZA

Mbledhja e kryesisë pritet të vendosë sot edhe për raportin e analizës së zgjedhjeve të 21 qershorit. Pas humbjes së thellë, PD pritet të nisë një proces ristrukturimi përpara parlamentareve të 2017-ës

sot si qytetarë të përgjegjshëm se nëse do të jetë vonë", tha ai. Vetë kryetari demokrat, Basha ka deklaruar më herët se dëgjesat me qytetarët do të jenë në funksion të studimit të realitetit aktual sot në vend, problemeve të shkaktuara dy vitet e fundit nga qeveria e majtë, që sipas opozitës e kanë zhytur vendin në krizë ekonomike, korrupsion dhe kriminalitet.

KRYESIA

Kryesia e Partisë Demokratike do të mbledhet sot rreth orës 19:00 në funksion të ana-

lizës së zgjedhjeve të 21 qershorit, me qëllim riorganizimin apo forcimin e strukturave të saj përpara zgjedhjeve të 2017-ës. Kryesia do të diskutojë mbi raportin e përgatitur nga grupi i punës për procesin zgjedhor për problematikat dhe rezultatet në çdo qendër votimi, fshatra dhe qytete të përfshira tashmë në 61 njësi vendore, 15 prej të cilave u fituan nga demokratët. Raporti do të jetë edhe baza e veprimtari të Partisë Demokratike, ku nuk përjashtohet edhe një riorganizim i strukturave. Gjithashtu, Partia Demokratike po përgatit



dhe alternativën me të cilën do të aspirojë rikthimin në pushtet, një program ekonomik të cilin kryetari Basha e quan paketa ekonomike e nxjerrjes së vendit nga kriza. Paketa ekonomike ishte një nga 5 prioritetet që mbledhja e mëparshme e kryesisë miratoi për veprimin e saj politik, krahas dekriminalizimit, dorëheqjeve të Tahirrit dhe Metës, hetimit ndërkombëtar dhe rikthimit të standardeve të zgjedhjeve të lira. Afera e CEZ dhe protestat e opozitës, do të zënë gjithashtu një vend të rëndësishëm në mbledhjen e sotme të kryesisë së PD, pasi dy ditë më parë mazhoranca rrëzoi në Kuvend kalimin me procedurë të përshpejtuar të priligjit për hetimin ndërkombëtar.

REFORMA

PD depoziton 54 vërejtje për draftin e mazhorancës



Partia Demokratike depozitoi dje në Kuvend opinionet për amendamentet e njëanshme kushtetuese të hartuara nga mazhoranca për reformën në drejtësi. PD kundërshton nismën e ndërmarrë nga mazhoranca duke prezantuar 54 vërejtje mbi përmbajtjen dhe cenimin e standardeve nga projektligji i hartuar në mënyrë të njëanshme sipas PD. Në njoftimin e saj, Partia Demokratike thekson se opinion që do t'i përcillet zyrtarisht Komisionit të Venecias ka përjashtuar rreth 230 pyetje drejtuar ekspertëve. "Në materialin prej 55 faqe, ekspertët e PD kanë kundërshtuar nismën e ndërmarrë nga mazhoranca, duke prezantuar plot 54 vërejtje mbi përmbajtjen dhe cenimin e standardeve nga projektligji i hartuar në mënyrë të njëanshme vetëm nga ekspertët e mazhorancës", thuhet në deklaratën e PD. Opozita në Opinionin që do t'i përcillet zyrtarisht Komisionit të Venecias, ka parashtruar edhe rreth 130 pyetje drejtuar eksperteve të Venecias.

VIZITA NË BERLIN/BASHA: HETIM TË PLOTË DHE TË BESUESHËM

CDU dhe Merkel mbështet hetimin për CEZ

Reagimi

**Alban Zeneli:
Sajmir Tahiri,
nxitje për krimin
dhe drogën**

PD nëpërmjet një deklaratë për shtyp ka akuzuar sërish ministrin e Brendshëm Tahiri. Deputeti i PD Alban Zeneli tha se rendi është në pikën e tij me kritike dhe se biznesi kriminal i drogës vazhdon me ritme të larta. Deputeti demokrat tha se "Tahiri është një nxitje për krimin dhe për trafikun e drogës". Grupet kriminale kanë krijuar imunitet dhe do të jenë gjithmonë të paprekshëm me një Ministër të Brendshëm si Tahiri", tha ai. PD e quan largimin e Sajmir Tahirit nga posti i Ministrisë të Brendshëm si emergjencë për vendin. "Largimi i tij dhe hetimi i plotë i lidhjeve kriminale do të hapte rrugën për rivendosjen e rendit në vend, për luftën ndaj krimi e ndaj trafikut të drogës", theksoi ai.

CDU e kancelares Angela Merkel mbështet kërkesën e Partisë Demokratike për thirrjen e prokurorëve të huaj, për hetimin e CEZ-it. Kështu u shpreh dje kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha pas vizitës dy ditore që zhvilloi në Bundestagun gjerman. Kreu i opozitës tha se ka zhvilluar takime me zyrtarë të lartë të CDU, të cilët sipas tij, janë shprehur në favor të hetimit ndërkombëtar, si e vetmja mundësi kjo që garanton besueshmërinë e hetimeve për aferën CEZ-DIA. "Mega afera CEZ, ishte po ashtu çështje e besidës. Mora mbështetjen e plotë të partnerëve tanë gjermanë, për iniciativën e Partisë Demokratike, për të angazhuar hetues ndërkombëtarë për zbardhjen e kësaj afere si mënyra më e mirë për një hetim të plotë dhe të besueshëm", u shpreh Basha pas takimeve me zyrtarë të lartë të CDU. Kreu i PD, gjatë qëndrimit në Berlin, ka takuar kreun e Komisionit për Çështjet Europiane në Bundestag, Gunther Krichbaum, me të cilin ka ndarë shqetësimin e shkeljeve të konstatuara në raportin e OSBE-ODIHR për zgjedhjet. "Deputetët gjermanë dhe kreu i Komisionit për Çështjet Europiane në Bundestag, Gunther Krichbaum, i kanë cilësuar tërësisht të papranueshme për një vend që aspirojnë të bëhet anëtarë i Bashkimit Europian,



Gunther Krichbaum dhe Lulzim Basha

shkeljet e konstatuara në raportin e OSBE-ODIHR-i, për zgjedhjet", tha ai. Gjithashtu sipas Bashës, CDU mbështet edhe propozimin e hershëm të demokratëve, atë të procesit të dekriminalizimit të politikës si dhe inkurajon mratimin me konsensus të ligjit. "Kush t'i panegociueshëm për fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian mbetet për partnerët gjermanë, dekriminalizimi i politikës shqiptare. Gjatë takimeve që zhvillova në Berlin, deputetët gjermanë vlerësuan propoz-

HETIMI

"Mega afera CEZ, ishte po ashtu çështje e besidës. Mora mbështetjen e plotë të partnerëve tanë gjermanë, për iniciativën e Partisë Demokratike, për të angazhuar hetues ndërkombëtarë për zbardhjen e kësaj afere si mënyra më e mirë për një hetim të plotë dhe të besueshëm"

imet e Partisë Demokratike dhe inkurajuan miratimin me konsensus të ligjit për dekriminalizimin", theksoi Basha. Një tjetër mbështetje e CDU për PD-në ka shkuar edhe për hartimin e programit të saj qeverisë, në funksion të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare. "Partia Demokratike po bashkëpunon ngushtësisht me kristiandemokratët e Kancelares Angela Merkel për hartimin e alternativës së saj; programin qeverisës të demokratëve për zgjedhjet e ardhshme parlamentare", theksoi më tej kreu demokrat, Basha.

LORENC RABETA
TIRANE

Ministria e Transporteve ka bërë publik paketën e re të masave që parashikon ashpërsim të ndëshkimeve ndaj informalitetit si dhe shkeljet e sigurisë në këtë sektor. Ministri Haxhinasto paraqiti pikat kryesore të paketës, duke theksuar se parashikohen gjoja deri 100 mijë lekë deri konfiskim të mjeteve, për subjektet e transportit publik, ndërkohë që parashikohet edhe licencimi profesional i punonjësve të serviseve të automjeteve. Paketa e re e masave e miratuar në mbledhjen e Qeverisë, synon rregullimin e tregut të taksive, rregullimin e tregut të shit-blejes dhe importimit të makinave nga individë të caktuar, apo pajisja me bileta e gjithë pasagjerëve që përdorin transportin interurban.

Ministri: Rregulla të reja, mekanikët jo më të pacertifikuar

Siguria dhe evazioni, Haxhinasto: Gjobjë 100 mijë lekë autobusëve për biletat



Edmond Haxhinasto

GJOJA

Paketa parashikon kontroll të rreptë ndaj të gjithë mjeteve të transportit publik taksi dhe autobusë që kryejnë aktivitet të palicencuar. Do kryhen kontrole me grupe të përbashkëta të policisë rrugore dhe të shërbimeve të transportit rrugor. Në rast shkellesh gjobjë deri në 100 000 lekë apo dhe konfiskim mjete. Po ashtu, do të kontrollohen autobusët e shërbimit interurban për pajisjen me bileta të pasagjerëve. Shoqëritë e transportit të marrin masa për pajisjen me blloqe të biletave nga drejtoritë tatimore. Në rast shkellesh gjobjë deri në 100 000 lekë dhe pezullim license. "Gjithashtu shumë e rëndësishme në këtë sektor ose në këtë nëngrup le të themi do të jetë çështja e biletimit. Do të ushtrojmë kontrole shumë rigoroz me qëllim që të gjithë qytetarët që përdorin shërbimet e transportit veçanërisht atij ndërqytetas të marrin biletën dhe patjetër tu ofrohet dhe shërbimi për të cilën ata kanë paguar, në mënyrën më të plotë, në mënyrën më cilësore që mund të ofrohet sot", theksoi Ministri. Për sa i përket sigurisë që ofron transporti publik, Ministri tha se rreth 80 % e mjeteve janë jashtë çdo lloj kategorizimi dhe standardi, prandaj është përcaktuar edhe plani i rinovimit të flotës së autobusëve që shërbejnë për transportin ndërqytetas.

SERVISET

Shërbimi servisit të automjeteve, sipas Haxhinastos, gjithashtu ka nevojë për rregullim, jo për licencim pasi ai bëhet nga QKL-ja po për certifikimin e atyre që do të operojnë në këtë fushë. Aktiviteti i këtyre operatorëve është shumë i rëndësishëm për sigurinë e jetës së qytetarëve prandaj ata që punojnë në pikat e servisit duhet të jenë të certifikuar për të ofruar shërbime

BASHKËPUNIMI

Ministri: Noterët do verifikojnë detyrimet



Sipas Ministrisë së Transporteve, rreth 90% e mjeteve të përdorura sot blihen në mënyrë të pakontrolluar, të parregjistruar. Për të disiplinuar këtë treg, Ministria do të bashkëpunojë me noterët, të cilët do të verifikojnë detyrimet e mjeteve në çastin e ndërrimit të pronësisë. "Sigurisht një angazhim shumë të rëndësishëm do të ketë nga ana e shërbimit të noterisë. I cili do të jetë i domosdoshëm në realizimin e transferimit të pronësisë. Gjithashtu edhe në momentin e regjistrimit të pronësisë do të kemi gjithashtu ndryshimet përkatëse, automjetet duhet të jenë të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme apo në degët e drejtorisë së Shërbimit të Transportit Rrugor, me qëllim që makinat të jenë paraprakisht të regjistruara në sistemin dhe për këtë do të krijojmë mundësi noterëve që të kenë akses të plotë në bazën e të dhënave që ka Drejtoria e Shërbimeve të Transportit Rrugor", tha Ministri Haxhinasto.

BILETAT

Në rast evidentimi shkellesh do ndëshkohen me gjoja maksimale 100 mijë lekë apo dhe konfiskim mjete. Po ashtu, do të kontrollohen autobusët e shërbimit interurban për pajisjen me bileta të pasagjerëve

SERVISET

Certifikimi i serviseve, do të bëhet nga njësitë e specializuara pranë ministrisë në bashkëpunim me drejtorinë e përgjithshme të shërbimeve të transportit rrugor. Ky është certifikimi veprimtarisë

të shkosh të marrësh licencën në QKL, por për ta marrë atë licencë si profesionet e tjera, duhet të kesh disa veçori të



IFC International Finance Corporation
WORLD BANK GROUP

The International Finance Corporation (IFC), a member of the World Bank Group, creates opportunity for people to escape poverty and improve their lives. IFC fosters sustainable economic growth in developing countries by supporting private sector development, mobilizing private capital, and providing advisory and risk mitigation services to businesses and governments.

COUNTRY OFFICER Tirana, Albania

The Country Officer will be responsible for leading all aspects of the IFC Investment and Advisory Services program in the country along with business development and relationship management with key stakeholders. Represent IFC vis-a-vis the Government, donor and business community. Maintain strong relationships with key ministries, agencies, and business community. Ensure IFC representation/involvement at key private sector and public sector events. In cooperation with regional management support development and execution of the country strategy. Lead business development for investment projects and oversee advisory projects. Oversee gathering of information on sectors, trends, and terms of domestic and international investment. Support development of overall country office communications strategy.

The right candidate will have strong drive and initiative, a successful track record in management (preferably in private sector development in transition economies), experience in banking, auditing, relationship management in public/private sector/technical advisory services particularly related to private sector development and/or business environment (7 or more years), professional or educational background in investment/financial analysis and/or business operations, advanced degree in business, economics, law, public administration or related field, excellent relationships in the business community and in Government, proficiency in English and Albanian.

For corporate information visit www.ifc.org.
Please apply and get more details on a position at
Careers - Job reference # 152041.
Deadline for applications is October 13, 2015

PLANI I MASAVE MBI ANTI-INFORMALITETIN

- Mjete transportit publik taksi dhe autobusë që kryejnë aktivitet të palicencuar. Do kryhen kontrole me grupe të përbashkëta të policisë rrugore dhe të shërbimeve të transportit rrugor. Në rast evidentimi shkellesh do ndëshkohen me gjoja maksimale 100 000 lekë apo dhe konfiskim mjete.
- Do kontrollohen taksitë e pajisura me taksimetër mbi përdorimin e rregullt të tij. Në rast parregullsisht do vendosen gjoja 20 000 lekë nga organet e policisë rrugore apo të shërbimit të transportit rrugor dhe tërheqje e licensës.
- Do rishihen kushtet e licencimit të taksive dhe kushtet e komoditetit të tyre.
- Do të kontrollohen autobusët e shërbimit interurban për pajisjen me bileta të pasagjerëve. Shoqëritë e transportit të marrin masa për pajisjen me blloqe të biletave nga drejtoritë tatimore. Në rast shkellesh gjobjë deri në 100 000 lekë dhe pezullim license.
- Formalizim i tregut, mjeteve të përdorura të regjistruara për herë të parë. Kufizime për importin e mjeteve nga individë.
- Verifikim nga noterët i detyrimeve të mjeteve që ndërrojnë pronësinë.
- Kontrole të pikave të grumbullimit të mjeteve.
- Kontrole të subjekteve që kryejnë transport mineralesh apo karburanti mbi peshë.
- Certifikim i serviseve të mjeteve rrugore.
- Tarifat reklamash në anë të rrugës dhe kontrole ndaj dëmtimeve të infrastrukturës rrugore dhe ndërhyrje pa leje.

caktuara, si në cilësinë e kapaciteteve njerëzore, teknikë dhe përshtatshëm etj, ashtu edhe në aspektin e infrastrukturës së servilit", tha Haxhinasto.

RRUGËT

Vëmendje të madhe do t'i kushtohet edhe llojeve të mjeteve e ngarkesave që dëmtojnë rrugët. "Ndërhyrjet në rrugë të paatorizuara, shkar-

ravitjet, përdorimi rrugës jashtë standardit, duke mbingarkuar automjetet të ndryshme në mallrat e rënda që shkojnë përtej kapacitetit të lejuar të rrugës, të gjitha këto do të jenë objekt shumë i rëndësishëm i monitorimit, qoftë nga institucionet e kontrollit të ministrisë së Transportit e Infrastrukturës, ashtu edhe nga shërbimet e tjera", tha Haxhinasto.

QARKULLIMI

25% e makinave të paregjistruara, nën kontroll varrezat

Procesi i grumbullimit dhe nxjerrjes së mjeteve jashtë qarkullimit është tërësisht jashtë çdo kontrolli, ndërkohë që 25% e makinave në territorin shqiptar rezultojnë të paregjistruara. Gjithashtu, Sipas Ministrisë së Transporteve, "ka shumë mjete, janë rreth 25 % e mjeteve që figurojnë në bazën e sistemit tonë të të dhënave, që nuk paguajnë, nuk regjistrohen në mënyrë periodike". Kjo do të thotë se ose janë jashtë shërbimit, ose janë hedhur në varrezat e automjeteve, ose mund të kenë shkuar përsëri jashtë shtetit. "Prandaj për të stabilizuar këtë situatë, ne do të vendosim rregulla më strikte, përsa u takon çregjistrimit të mjeteve. Sigurisht referenca e kryqëzuar që themi, nëse një individ ose subjekt, ka disa automjete që rezultojnë në sistemin tonë të të dhënave, dhe 2 i paguan, pjesën tjetër nuk e paguan, do i kërkohet përgjigje edhe për të tjerat dhe mund të vazhdosh me regjistrimin



përkatës. Është e domosdoshme që kjo situatë kaq problematike të stabilizohet", theksoi dj. Edmond Haxhinasto. I pamonitoruar mbetet në masë të madhe edhe aktiviteti i një numri të madh individësh të cilët blejnë makina jashtë vendit për t'i shitur në tregun shqiptar. "Ky është shqetësimi, sepse një aktivitet shumë i madh tregtarë, i pamonitoruar, i pakontrolluar realizohet sot. Ka shumë tregje të tilla edhe në mes të Tiranës dhe me këtë nisim ku lloj aktiviteti ekonomik do të kontrollohet. Një individ nuk mund të importojë më shumë se 1 ose 2 automjete për përdorim personal në një vit", tha Haxhinasto.

Punonjësit social Klosi: Largohet nga puna kush ngel në testim

Testohen 544 punonjës socialë. Javës tjetër zhvillohet provimi me gojë

DRIÇIM ÇAKA
TIRANË

Nis testimi për 544 punonjës social. Ky provim ka nisur ditën e djeshme për të gjithë punonjësit, që nga fëmijët, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe deri te moshë e tretë. Ministri i Mirëqenies Sociale Blendi Klosi tha se punonjësit që nuk kalojnë provimin atëherë do të largohen nga puna. "Nëse testimi nuk del pozitiv, atëherë në bazë edhe të legjislacionit në fuqi, personeli që nuk kualifikohet mund të vazhdojë në sistemin tjetër, pra në atë të qytetarëve pa problematika, por në sistemin tonë ku kërkohet një shërbim më i specializuar, nuk mund të shërbejë dot", - tha Klosi. Për të qenë kalues

PROVIMI I DYTË

Javës tjetër zhvillohet testimi me gojë i punonjësve social

Kjo është faza e parë e testimit të punonjësve social, pasi duke filluar nga java tjetër ata do të testohen edhe me gojë. Në testimin me gojë do të jetë një komision i posaçëm i cili do të vlerësojë aftësitë e tyre lidhur me punën që bëjnë. Në testimin me gojë, punonjësit do të pyeten për mënyrën se si komunikojnë me pacientët dhe cilat janë metodat e tyre të punës. Testimi i 544 punonjësve me shkrim dhe me gojë po zhvillohet për herë të parë nga Ministria e Mirëqenies Sociale.

punonjësit duhet të grumbullojnë gjysmën e pikëve.

PROCESI

Pas skandalit në Shtëpinë e Fëmijës në Shkodër, ku dy

punonjësve ushtruan dhunë ndaj vogëlushëve, ministri Blendi Klosi dha urdhër për testimin e punonjësve. Ky urdhër ka filluar të zbatohet ditën e djeshme ku punon-



Ministri Blendi Klosi

jësit janë tetsuar me shkrim. Sipas Klosit ky testim synon që të identifikojë pikërisht ata punonjës socialë që kanë aftësi të mjaftueshme për t'iu ofruar shërbim kategorive shoqërore që kanë nevojë për përkujdesje. "Sot (dje) është 2 tetori, Dita Ndërkombëtare kundër Dhunës dhe ne jo më kot kemi zgjedhur këtë ditë për të realizuar atë që premtuam pas ngjarjes së Shkodrës, për të testuar që gjithë personelin në të gjitha qendrat rezidenciale, për të parë aftësitë e tyre në funksionin të detyrës që duhet të kryejnë. Ajo që

ndodhi në Shkodër nuk mund të themi që ishte as e para dhe as e fundit, por me testimin e sotëm ne synojmë t'iu ofrojmë qytetarëve në nevojë, grupeve shoqërore me problematika, atyre që kanë nevojë për dorën e shtetit, një shërbim më të kualifikuar", - u shpreh Ministri i Mirëqenies Sociale. Klosi shpjegoi se provimi nuk do të jetë vetëm për aftësitë analitike, por edhe ato psiko-analitike dhe për të kuptuar sesi punonjësit socialë reagojnë në raste dhe situata të ndryshme gjatë ushtrimit të detyrës.

LARGIMET

"Nëse testimi nuk del pozitiv, atëherë në bazë edhe të legjislacionit në fuqi, personeli që nuk kualifikohet mund të vazhdojë në sistemin tjetër, pra në atë të qytetarëve pa problematika"

RASTI

"Ajo që ndodhi në Shkodër nuk mund të themi që ishte as e para dhe as e fundit, por me testimin e sotëm ne synojmë t'iu ofrojmë qytetarëve në nevojë, grupeve shoqërore me problematika"

PYETJET

Në testimin me gojë, punonjësit do të pyeten për mënyrën se si komunikojnë me pacientët dhe cilat janë metodat e tyre të punës

Ndërkohë, për ata punonjës socialë që do ta kalojnë këtë provim, ai ka premtuar se do t'iu nënshtrohen kualifikimeve të vazhdueshme në mënyrë që të përmirësojnë më tej aftësitë e tyre të shërbimit. "Pas këtij testimi, ata që do të ndihen të aftë për të shërbyer në këtë sistem do t'iu nënshtrohen trajnimeve dhe kualifikimeve të vazhdueshme, pasi siç e thashë, është shumë e rëndësishme që të kemi nevojë për njerëz që dinë të japin shërbime për ato shtresa që kanë nevojë për përkujdesje", - tha Blendi Klosi.

LAJME SHKURT




Bashkia e Tiranës, plan masash për zhvendosjen e romëve

Bashkia e Tiranës ka lajmëruar një plan të detajuar masash për zhvendosjen e 50 familjeve romë nga zona e Liqenit Artificial, pranë Qendrës Transitore të Emergjencave në Tufinë. Stafi i Bashkisë së Tiranës, që do të merret me zhvendosjen e tyre, i ka lënë 10 ditë afat banorëve që të lirojnë hapësirën publike pranë Parkut të Liqenit, të cilën bashkia ka në plan ta rehabilitojë. Vendimi për të larguar këto familje romë të ardhura nga Elbasani dhe Berati, që prej disa vitesh qëndrojnë në një fushë në breg të liqenit, është marrë pas ankesave të vazhdueshme të banorëve të zonës për zhurmë dhe ndotje të mjedisit.

3DZ vjen në Tiranë, "në të ardhmen do printohen edhe organet"

Shqipëria është bërë përfaqësuese zyrtare e këtyre produkteve 3D sistem duke hedhur një hap gjigand në fushën e teknologjisë. "Uroj suksese dhe Dhoma e mirëpret dhe ashtu siç ofron bashkëpunim të ngushtë të kompanisë në mënyrë që të gjejë një shtrirje sa më të shpejtë dhe efikase në tregun shqiptar", tha Nikolin Jaka, kreu i domës së tregëtisë. Një muaj më parë, SHBA-të miratuan ilaçin e parë të printuar me teknikën 3D. Në të ardhmen, shkencëtarët pohojnë se edhe doktorët mund të printojnë organet për një person që ka nevojë për transplant.



Njohja e pensioneve, në Kuvend, marrëveshja me Maqedoninë

Marrëveshja për njohjen e ndërsjelltë të kontributeve të pensioneve mes Shqipërisë dhe Maqedonisë ndodhet në Kuvend. Sipas deklaratave të palës shqiptare, numri i përfituesve nga të dy vendet vlerësohet të jetë rreth 300 mijë. Marrëveshja "Për mbrojtjen shoqërore" e firmosur në Shkup nga ministrat e Mirëqenies Sociale të dy vendeve, parashikon trajtimin e barabartë të punëtorëve në punësim, trajtimin me përfitime dhe të ardhura. Zbatimi i marrëveshjes nuk do të ketë efekt financiar të menjëhershëm, pasi e drejta për përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, shtetasve shqiptarë u lind kur ata të kenë mbushur moshën për pension.

HEC-et e vogla humbasin gjyqin ndaj KESH për rregullimin e çmimit

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare ka "larë duart" me borxhet ndaj prodhuesve të vegjël të energjisë, pasi ata humbën gjyqin kundër KESH-it për rregullimin e çmimit me ulje për periudhën rregullatore 2012-2014. Vitin e shkuar, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) morri një vendim duke rregulluar me ulje çmimin e energjisë elektrike që KESH jep ndaj HEC të vogla deri në 15 megavatorë. Shoqata e prodhuesve të Energjisë çoi në gjykatë këtë vendim të ERE, por siç njoftoi Ministria e Energjitikës, gjykata ka vendosur në favor të ERE duke e "zhveshur" KESH-in nga shlyerja e rreth 5 milionë eurove.



Projekti i naftës në Nartë, Dedej: Impakti në mjedis të jetë minimal

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka organizuar dje në Vlorë, një takim me 12 administratorët e Zonave të Mbrojtura të qarqeve të Shqipërisë, për vënitën në efikasitet të këtyre Zonave sipas programit elektronik MMT. Drejtori i AKZM-së, Zamir Dedej, u pyet lidhur me projektin për kërkim naftë në zonën e mbrojtur në Nartë. "Do bëhet çështje e mundur nga vendimarrësit që të mos preket zona e mbrojtur dhe impakti në mjedis të jetë minimal", u përgjigj Dedej. Ai bëri me dije se do kryehën investime në zonën e mbrojtur detare Karaburun-Sazan dhe për ngritjen e qendrës së informimit në Llogara dhe Skelë.

Informaliteti në Shkodër, ndjekje penale për 33 subjekte

Prej dy muajsh, kohë dhe kur ka nisur aksioni kundër informalitetit, në Shkodër, sipas Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, janë kontrolluar rreth 4 mijë subjekte, nga ku kanë rezultuar me shkelje 340 subjekte, ndërsa 33 biznese janë sekuestruar dhe po ndiqen penalisht, pasi janë gjetur të paregjistruar. Kreu i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve në Shkodër, Hysen Hysaj, thotë se aksionet do të vazhdojnë deri në kontrollin e plotë të të gjitha bizneseve. Sipas Hysaj, Poziti është fakti që bizneset tashmë janë ndërgjegjësuar dhe po operojnë sipas ligjit.

Lotaria Amerikane si bëhet zgjedhja e fituesve

EMER MBIEMER
TIRANE

Në ditën e tretë të aplikimeve ambasada Amerikane sqaron se procesi i aplikimit dhe i njoftimit të fituesve do të bëhet "online". Ambasada ka bërë thirrje që shqiptarët të mos paguajnë për aplikimin apo për shërbime të tjera, pasi e gjithë procedura kryhet në internet. Lidhur me mënyrën se si do të përzgjidhen fituesit Ambasada Amerikane thotë se do të bëhet në mënyrë automatike dhe shqiptarët duhet vetëm të presin nëse kanë fituar ose jo. "Bazuar në shpërndarjen e vizave të disponueshme për çdo rajon dhe shtet, individët do të përzgjidhen rastësisht nga kompjuteri ndërmjet aplikimeve të kualifikuara. Për të gjithë aplikantët e DV-2017 do të kërkohet të shkruajnë tek Kontrolli i Statusit të Regjistruarve duke përdorur numrin unik të konfirmimit të ruajtur nga regjistrimi DV-2017 i aplikimit të tyre në internet për të gjetur nëse aplikimi i tyre është përzgjedhur në programin e DV. Kontrolli i Statusit të Regjistruarve do të jetë në dispozicion në faqen e internetit të E-DV ee.dvlottery.state.gov duke filluar nga 3 maji 2016 deri të paktën më 30 qershor 2017. Nëse aplikimi juaj përzgjedhet, ju do të drejtoheni tek një faqe konfirmimi që do ju japë udhëzime të mëtejshme, përfshirë informacione për pagesat lidhur me emigracionin në Shtetet e Bashkuara. Kontrolli i Statusit të Regjistruarve do të jetë mjeti i VETËM me cilin të përzgjedhurit do të njoftohen për përzgjedhjen e tyre për DV-2017. Departamenti i Shtetit nuk do të dërgojë letra njoftimi ose të njoftojë të përzgjedhurit me e-mail. Ambasadat e Shteteve të Bashkuara dhe konsullatat nuk do të sigurojnë lista për të përzgjedhurit. Individët të cilët nuk janë të përzgjedhur gjithashtu do të njoftohen vetëm përmes Kontrollit të Statusit të Regjistrimit. Ju jeni të inkurajuar fuqimisht të hyni vetë tek Kontrolli i Statusit të Regjistruarve dhe të mos mbështeteni tek dikush tjetër për të kontrolluar dhe për t'ju informuar. Nëse jeni përzgjedhur, në mënyrë që të merrni një vizë DV për të emigruar në Shtetet e Bashkuara, ju prapëseprapë duhet të përmblusni të gjitha kërkesat e pranueshmërisë sipas ligjit të SHBA-së. Këto kërkesa mund të rrisin nivelin e kërkuar të shqyrtimit dhe kohën e nevojshme për shqyrtim për vendastit e disa vendeve

Procedura

Nëse jeni përzgjedhur, në mënyrë që të merrni një vizë DV për të emigruar në Shtetet e Bashkuara, ju prapëseprapë duhet të përmblusni të gjitha kërkesat e pranueshmërisë sipas ligjit të SHBA-së. Këto kërkesa mund të rrisin nivelin e kërkuar të shqyrtimit dhe kohën e nevojshme për shqyrtim për vendastit e disa vendeve



dhe lëshimi i vizave DV të aplikantëve të përzgjedhur që kanë plotësuar kërkesat e duhura edhe për anëtarët e familjes së tyre duhet të

përfundojnë deri në mesnatë më 30 shtator 2017. Në asnjë rrethanë DV-të nuk mund të lëshohen apo të autorizohen pas kësaj date, dhe as

anëtarët e familjes së DV-së të cilët nuk e morën vizën në të njëjtën kohë me aplikantin kryesor nuk mund t'i bashkohen aplikantit kryesor në

Hapat Ambasada: Nëse fitoni nuk j'u jepen lek, as strehim

Nëse fitoni llotarinë amerikane atëherë nuk do t'ju paguhet bileta e udhëtimit, as nuk do t'ju ofrohet punë apo strehim. Çdo gjë fituesit duhet ta arrijnë vet. "Qeveria e SHBA-së nuk do të japë asnjë nga këto shërbime nëse ju merrni një vizë nëpërmjet programit të DV-së. Nëse jeni përzgjedhur për të aplikuar për një vizë DV-je, do t'ju kërkohet të dëshmoni se nuk do të bëheni barrë publike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përpara se të pajiseni me vizë", - thuhet në udhëzuesin për aplikimin me llotarinë amerikane. "Nëse jeni një aplikues i përzgjedhur rastësisht, ju do të merrni udhëzimet mbi shqyrtimin e aplikimit të vizës së DV-së nëpërmjet Kontrollit



të Statusit të Regjistruarve tek dvlottery.state.gov. Ju do të paguani të gjitha tarifat e DV-së dhe vizës së emigrimit personalisht vetëm në Ambasadën ose Konsullatën e SHBA-së në kohën e aplikimit për vizë. Arkë-tari konsullor do ju japë menjëherë një faturë të qeverisë së SHBA-së për pagesën. Mos i dërgoni para askujt për tarifat e DV-së nëpërmjet postës, Eastern Union, ose kujt do shërbimi tjetër dërgesash nëse ju jeni duke aplikuar për një vizë emigrimi në një Ambasadë ose Konsullatë të Shteteve të Bashkuara, - thotë Ambasada Amerikane. Gjithashtu këshillohet që të mos e lini aplikimin për ditën e fundit, pasi sistemi edhe bllokohet nga kërkesat e larta.

NJOFTIMI

Nëse regjistrimi juaj nuk është përzgjedhur, ju nuk do të merrni udhëzime shtesë. Personat e përzgjedhur për programin e lotarisë DV-2017 kanë të drejtë të aplikojnë për lëshimin e vizave

Shtetet e Bashkuara pas kësaj date. Shih Pyetje të Bëra Shpesh për më shumë informacion në lidhje me procesin e përzgjedhjes, - thuhet në udhëzuesin për aplikimin e lotarisë amerikane.

NJOFTIMI

Ambasada Amerikane sqaron se njoftimet zyrtare të përzgjedhjes do të bëhen nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Regjistruarve, duke filluar nga 3 maji 2016, deri të paktën më 30 qershor 2017, në faqen e internetit E-DV dvlottery.state.gov. Departamenti i Shtetit nuk do të dërgojë njoftime për të përzgjedhurit apo letra me postë ose email. "Çdo njoftim me email ose letër që ju deklaron se jeni përzgjedhur për të marrë lotarinë nuk vjen nga Departamenti i Shtetit dhe nuk është i ligjshëm. Çdo komunikim me email që ju merrni nga Departamenti i Shtetit do ju drejtojë juve për të rishikuar Kontrollin të Statusit të Regjistruarve për informacion të ri në lidhje me aplikimin tuaj. Ju duhet të përdorni numrin tuaj të konfirmimit për të hyrë tek Kontrolli i Statusit të Regjistruarve (Entrant Status Check), që bëhet aktive në faqen e internetit të E-DV-së ee.dvlottery.state.gov nga 3 maji 2016 deri të paktën më 30 qershor 2017. Nëse regjistrimi juaj nuk është përzgjedhur, ju nuk do të merrni udhëzime shtesë. Personat e përzgjedhur për programin e lotarisë DV-2017 kanë të drejtë të aplikojnë për lëshimin e vizave vetëm gjatë vitit fiskal 2017 të Departamentit të Shtetit, i cili shtrihet nga 1 tetori 2016 deri më 30 shtator 2017. Nuk përfitojnë asnjë shtyrje të lotarisë për vitin e ardhshëm personat që janë përzgjedhur, por që nuk janë pajisur me vizë deri më 30 shtator 2017", theksohet në udhëzues. Gjithashtu, bashkëshortët dhe fëmijët që përfitojnë nga statusi i një të regjistruar të DV-2017 mund të pajisen me viza në kategorinë e DV-së vetëm nga 1 tetori 2016 deri më 30 shtator 2017.

LAJME shkurt

Korçë, qendrat ditore nuk përballojnë të moshuarit

Tri qendrat për trajtimin ditor të moshës së tretë në Korçë, nuk kanë kapacitetet për të përballuar numrin në rritje të të moshuarve për përkujdesje. "Fundja fundit ata janë të harruar aty. Këto që rrinë në këmbë e shkojnë në qendrat ditore, që quhen qëndra ditore por që pijnë kafe, kurse ata që rrinë në shtëpi vetëm janë keq", thotë drejtoresha e një qëndre ditore. Ndërkaj, janë shumë të moshuar të tjerë që nuk përballojnë dot tarifën mujore që duhet paguar në qendrat e posaçme.

Kukës, pensionistët mbajnë familjen me bukë

Në qarkun e Kukësit ndodh rëndom që pensionistët "të mbajnë familjen me bukë". Përballë situatës ku fëmijët e tyre nuk kanë një vend pune, të moshuarit kursejnë në maksimum, që me pensionin e tyre të mund të sigurojnë ushqimet, të blejnë ilaçet dhe paguajnë energjinë. Në qarkun e Kukësit numërohen më shumë se 18 mijë pensionistë, ndërkohë që numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike është afro 10 mijë. Zyrtarisht të regjistruar si të papunë në zyrat e punës janë 7 mijë vetë.

Shqipëria dorëzon dokumentin për reduktim të Gazeve

Ministria e Mjedisit ka dorëzuar dokumentin që përcakton Kontributin Kombëtar të Synuar për reduktim të Gazeve me Efekt Serrë (INDC) në Sekretariatin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Burime pranë ministrisë së Mjedisit bëjnë me dije se Shqipëria përmblus një nga detyrimet e saj në përputhje me rekomandimet e BE-së në Progres Raportin e vitit 2014, duke qenë kështu në linjë me objektivat e BE-së deri në vitin 2050.

Ismailaj pastrim parash 3 mln \$ drejt parajsave fiskale


Zbulohen dokumentet, si qarkullonin paratë në vitin 2006 dhe dyshimet për pastrim parash

ELTON QYNO
TIRANË

Para se të nënshkruante kontratën e shumë përfolur për mbledhjen e borxheve të "CEZ Shpërndarje", Kastriot Ismailaj rezultoi të jetë përfshirë në një rrjet të madh ndërkombëtar të transfertave të parave.

TRANSFERTAT E ISMAILAJ

Në vitet 2006-2008, sipas këtyre dokumenteve në llogaritë e Kastriot Ismailaj janë depozituar 4,598,501 USD dhe 800.000 EURO, të gjykuara nga prokuroria si para me burim të pajustifikuar. Këto para Ismailaj i ka përfutur nga kompania "Hassans Client2AC", me adresë "57/63 Line 60ll Road, Neë York, e cila rezultoi që në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është e dyshuar për transferata të paligjshme. Gjatë periudhës 2006-2008 në llogarinë e Kastriot Ismailaj në një bankë të nivelit të dytë në Tiranë, mbërrin 4,598,501 USD dhe 800.000 EURO. Këto para mbërrin nga shoqëria "Hassans Client2AC", me adresë "57/63 Line 60ll Road, Neë York, USA", por po ashtu ka dhe transferata të tjera nga United Recouces Ag, ST. Gallerstrasse 19, Zvicër dhe DOMINICUS Ag, ST. Gallerstrasse 19, po në Zvicër. Por pa qëndruar shumë kohë në Shqipëri, 3 milion dollar transferohen nga Kastriot Ismailaj jashtë vendit ku nuk përjashtohet dhe mundësia e pagesave në formë rryshfeti për zyrtarët vendas, operacioni kryer nëpërmjet kompanisë së Ismailajt Adriatic "Development Corporation". Sipas vendimit të gjykatës e cila ka vendosur sekuestro për llogaritë bankare të Kastriot Ismailaj, rezultoi se 2,994,376 USD, Ismailaj i kishte transferuar të strukturuar në shumë të ndryshme, ku si përfuttes ishin kompani dhe persona të ndryshëm në shtetë të ndryshme të njohura si parajsë fiskale. Kastriot Ismailaj në këto transferata ka vendosur dhe arsyen e pagesës për kompanitë ende të paidentifikuara jashtë vendit, ku sipas gjykatës arsyet janë pagesa për studime fizibiliteti në projekte minierash,



Faksimile e transaksioneve bankare të kryera nga nga Kastriot Ismailaj

Janë mbyllur brenda një viti, gjë e cila të krijon dyshime të forta se ato janë krijuar vetëm për këtë skemë të mbledhjes së parave.

konsulencë ligjore, pagesë shërbim telefonike, shërbime zyre si dhe shërbime udhëtimi. Kompania "Debt International Advisory"- Dega Shqipëri që ishte kontraktuar nga "OSSH" dhe "CEZ Shpërndarja" për mbledhjen e borxhit financiar tek 318,000 konsumatorëve të energjisë elektrike, nuk ka kryer vetëm

këtë funksion, por dyshohet se ka pastruar miliona euro dhe dollarë të individëve me pushtet politik dhe personave VIP në Shqipëri.

HETIMET

Kur e gjithë situata publike dhe politike është qëndruar

rrëth hetimeve që po krye prokuroria për mega mashtrimet 5 mln euro që dyshohet se është kryer nga kompania "Debt International Advisory" e Kastriot Ismailaj, në fakt ekzistoi dhe një dosje nr.2 në prokurori, e cila prej disa muaj po heton veprimtarinë tregtare të 9 kompanive që mbledhën lekët e qytetarëve Shqiptarë për llogaritë CEZ. Hetimet për dosjen nr.2 ku dyshohet se është bërë një tjetër megamashtrim me 4 milion euro, kanë nisur për akuzën e "pastrimit të parave" dhe "Mashtimit". Bëhet fjalë për 9 kompanitë që janë kontraktuar nga "CEZ Shpërndarja" dhe që prej gati një viti ato kanë mbledhur shumë të konsiderueshme lekësh, tek konsumatorët që konsideroheshin si borxhlija nga ish-drejtesit e CEZ. Momentalisht praktika hetimore është fokusuar në mënyrën se si janë hapur këto kompani dhe koha tepër e shkurtër e veprimtarisë tregtare, pasi gjatë

nga këto firma nuk ekzistojnë më. Ato janë mbyllur brenda një viti, gjë e cila të krijon dyshime të forta se ato janë krijuar vetëm për këtë skemë të mbledhjes së parave dhe më pas kanë pushuar së ekzistuari. Disa prej këtyre kompanive janë hapur nga biznesmenë të njohur në Shqipëri, por që tashmë kompanitë

Praktika hetimore është fokusuar në mënyrën se si janë hapur këto kompani dhe koha tepër e shkurtër e veprimtarisë tregtare.

e tyre rezultojnë të ç'regjistruar.

PYETJA E ADMINISTRATORËVE

Për llogaritë të hetimit të dosjes Nr.2 të kompanisë "CEZ Shpërndarja", prokuroria e Tiranës ka sekuestruar kontratat që kanë nënshkruar të gjitha firmat me

"CEZ Shpërndarja". Duhet thënë se në 2013 ka ekzistuar një hetim nga prokuroria e Tiranës për 9 subjektet, por është pezulluar dhe më pas ka qenë kryeprokurori Llalla ai që ka shfuqizuar vendimin e pezullimit të përpiluar nga dy prokurorë dhe fill pas kësaj, kanë rinisur sërish hetimet. Burimet nga prokuroria thënë se kanë marrë në pyetje dhjetëra persona, mes tyre dhe disa administrator të këtyre firmave. Pyetja e të gjithë personave nuk është kryer, kjo pasi disa prej tyre ndodhen jashtë shtetit, pasi janë shtetas të huaj si shqiptaro-amerikan, një shtetas Çek, një

Italian dhe një Gjerman. Tre shqëritë si: "CEZ Services" Sh.p.k., "CEZ Debt Management" Sh.p.k., "CEZ DEBT COLLECTION", janë hapur në muajin Mars-Prill të vitit 2012 dhe se më pas janë mbyllur në periudhën kohore 26 dhjetor 2013 dhe 27 maj 2013.



Prifti: I gatshëm të ndihmoj qeverinë në gjyqin ndaj DIA


"Marrëveshja midis CEZ-it dhe DIA-s ka qenë korruptive e përkrahur politikisht nga kreu i parlamentit Ilir Meta"

LEONARD QUKU
TIRANË

Ish-ministri i Energjetikës, Dritan Prifti u shpreh dje për mediet, pas marrjes në pyetje në Drejtorinë e Policisë së Tiranës, se është i gatshëm të ndihmojë qeverinë shqiptare në gjyqin kundër shoqërisë DIA. Ai u mor në pyetje për rreth 3 orë në kuadër të verifikimeve që institucionet ligj zbatuese kanë nisur për letrën që kreu i komisionit parlamentar të Sigurisë, Spartak Braho iu drejtohet kreut të shtetit për një plan destabiliteti në vend të përgatitur nga Dritan Prifti dhe Tom Doshi kundër Ilir Metës.

Prifti tha se jo vetëm që nuk e ka kërcënuar bashkëshorten e Kastriot Ismailajt, administratorit të kompanisë DIA që do mblidhte borxhet ndaj CEZ, por as që e njeh atë. Ish-politikani vijoi me akuzat kundër kryeparlamentarit Meta, duke thënë se nga kontrata me DIA-n kanë përfituar njerëz të afërt të tij.

"Sqarova në polici që unë nuk e kam takuar dhe nuk e njoh bashkëshorten e Ismailajt. Po ashtu sqarova që edhe Kastriotin duhet të kem 10 apo 12 vjet pa e parë dhe takuar. S'kam biseduar kurrë me asnjë në lidhje me arbitrazhin. Madje nëse qeveria dëshiron që të jem dhe unë dëshmitar në krah të qeverisë kundër DIA-s për arbitrazhin jam i gatshëm që ta ndihmoj qeverinë. Jam i bindur që kontratat mes CEZ dhe DIA ishin kontratë korruptive e ndikuar nga Ilir Meta. Kam thënë që para nga DIA kanë shkruar të miq të afërt të Metës, botërisht të njohur sepse është një biznes në Durrës, të



Dritan Prifti

Akuzat

"Jam i bindur që kontratat mes CEZ dhe DIA ishin kontratë korruptive e ndikuar nga Ilir Meta. Kam thënë që para nga DIA kanë shkruar të miq të afërt të Metës"

cilës nuk ia ka përmend asnjë media emrin dhe kuptohet se pse", deklaroi Dritan Prifti. Duke komentuar letrën e Brahos për një plan për të destabilizuar vendin, Prifti tha se ai kursesi nuk ka një qëllim të tillë, ndërsa shtoi se vetë qeveria është e destabilizuar.

"Pjesa e dytë e deklaratave të mia kishte të bënte me faktin që unë po përpigëz të krijoj destabilitet politik. Unë nuk jam pjesë e asnjë grupi politik që ka në fokus destabilitetin. Ne sot kemi destabilitet sepse LSI është si ajo grua që është martuar për herë të dytë dhe sa herë i shkon mendja te burri i parë shkon me burrin e parë. Kjo nuk është qeveri stabël. Janë dy parti ku njëra vjedh nga mëngjesi deri në darkë dhe tjetra dhuron qytetarët", shprehet ish deputeti. Ai akuzoi edhe njëherë tjetër deputetin e LSI, Agron Çela se kompania e tij ka marrë rreth 16.5 milionë euro nga DIA. Gjithashtu, Prifti tha se është i gatshëm që të deklarojë jo vetëm për DIA-n, por edhe në lidhje me hetimet e CEZ.

Ambasadorja

Tomasova:
Veto ishte për reformat, jo për CEZ



Ambasadoreja e Republikës së Çekisë në Shqipëri Broislava Tomasova ka hedhur poshtë të gjitha zërat e kthyer në akaza politike të opozitës kundër qeverisë, se vendi i saj kishte vënë kusht për heqjen e vetos ndaj Shqipërisë firmosjen e marrëveshjes me CEZ. Ajo tha se Çekia e bazon veton për statusin e vendit kandidat për në Bashkimin Evropian siç ishte Shqipëria, vetëm në reformat dhe progresin e bërë. "Marrëveshja CEZ është mbyllur para se të diskutohet veto për statusin e vendit kandidat. BB dhe KE e kanë mbështetur këtë marrëveshje me CEZ. Ndërkohë republika çeke si një vend kandidat para se të japë veton shikon progresin e një vendi, integrimin dhe reformat", tha Tomasova.

GENC POLLO

"Disa media shkruajnë se nuk kam votuar dje në Kuvend për ligjin e hetimit ndërkombëtar të CEZ-it. Spekulojnë. Mund edhe të shtonin se ndodhesha në Berlin, vizitë në Bundestag. Pra pamundësi fizike për të votuar. Me fare pak punë hulumtuese".

ALFRED PEZA

"Çështja e CEZ është një tentativë e ish-kryeministrit Sali Berisha për të marrë pushtetin në tavolinë. E përdorën për të krijuar përçarje PS-LSI dhe me idenë që të bjerë qeveria. E gjitha një shaka e Sali Berishës".

Sali Berisha

"Mungesa në Kuvend, keqkuptim, nuk tërhiqemi"

Ish-kryeministri, Sali Berisha, i cili në një kohë është akuzuar dhe i akuzuar për aferën CEZ, nuk ishte i pranishëm në votimin e Kuvendit për nismën e PD-së për hetim ndërkombëtar të përsheptuar. Por përmes një reagimi dje, Berisha ka justifikuar mungesën e tij në Kuvend gjatë momentit të votimit, se ishte keqkuptuar nga përfundimet e mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve, ku u tha se ligjin kalon me shumicë të cilësuar votash prej 3/5. "Mungesa ime dje në votim kishte shkak të vetëm një keqkuptim timin mbi pro-



cedurën dhe mënyrën e votimit pasi mazhoranca në mbledhjen e Konferencës së Kuvendit me absurditetin e kishte cilësuar projektligjin si organik, pra që duhet të votohet me 3/5. Të gjitha komentet e papagajve të qeverisë, të dëshmitarëve të saj të rremë që nxijnë me praninë e tyre në studiot televizive, por dhe të eklektikëve dhe relativistëve, pra krypto-avoketëve të qeverisë, janë absolutisht pa baza", u shpreh ai. Berisha deklaroi gjithashtu se nuk është tërhequr nga kërkesa për hetim ndërkombëtar për aferën Rama-Meta-CEZ.

Ylli Manjani

"DIA" po viktimizohet me qëllim që të fitojë në arbitrazh

Nënkryetari i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Ylli Manjani u shpreh dje se çështja "CEZ" mund t'i kushtojë shtetit shqiptar dhe të dëmtojë interesin publik. Në një deklaratë para mediave, Manjani tha se politizimi i tejskajshëm ka një synim, të viktimizojë DIAn para arbitrazhit, duke sjellë fitoren e saj. "CEZ mund t'i kushtojë realisht shtetit shqiptar, mund t'i kushtojë opinionit publik sepse politizimi i tejskajshëm, nga grupe politike, tregtare por edhe mediatike, ka një synim të vetëm. Një synim i cili kërkon të viktimizojë me çdo kusht DIAn



para arbitrazhit kundër shtetit. Precedentë që njihen. Ky është shqetësim real", u shpreh ai. "Grupi mediatik tregtar sigurisht i nisur nga DIA vetë, personat pjesëmarrës janë duke krijuar gjullurdi politike, mediatike, duke krijuar idenë se gjithë shteti është kundër një tregtari. Është krijuar kjo përshypje, që fillon me një falsifikim, një shpifje të një gazetari, një debat politik të stisur, akuzat të nxitura nga opozita. Shpifje që duan të dëmtojnë figurën e Ilir Metës, për ta bërë gjasë në dukje këtë skenar real, por në të vërtetë për ta fshehur", deklaroi Manjani.

'Nëse Aurora merrej me drogë nuk do ti punonte babai roje'

Flet kushërira e Aurora Oskian, B. Oskian: Nuk i njihja djemtë që ishin në makinë

XHENSILA KODRA
TIRANE

Familja Oskian kishte hapur dyert e mortit për humbjen e vajzës së tyre, Aurora. 29 vjeçarja humbi jetën dy ditë më parë, pasi u qëllua me automatik nga persona të pa identifikuar, në drejtim të BMW-së ku ndodhej me shoqen e saj më të ngushtë dhe dy meshkuj. Nga të shtënat gjeti vdekjen Klevis Rugova dhe u plagos Elvis Gaçaj. Ndërsa, vajza me iniciale E.Gj u largua nga makina sapo ka dëgjuar të shtënat. Familja Oskian jeton në katin e pestë të një pallati pas shkollës "Pjetër Budi", në rrugën "Muhamet Gjollështa", në Tiranë. Dje, edhe komshinjtë e kësaj familjeje ishin në zi. "Humbëm një vajzë të mirë e të dashur. Edhe ne si komshinj jemi në zi për këtë. Nuk e besojmë se çfarë ndodhi. Vajza vjen nga një familje e mirë dhe punëtore", shprehet nëpër shkallë një grua rreth të 40-ve. Teksa ngjitemë në katin e pestë të pallatit dëgjojmë të qara me zë dhe persona të veshur me të zeza që hynë e dalin nga shtëpia. Në një intervistë për gazetën "Shqiptarja.com" ajo shprehet e dëshpëruar se ajo që i kishte ndodhur motrës (kështu e quante gjithmonë) së saj ishte një ngjarje e pa besueshme. "Nuk mund ta kuptoj këtë që ndodhi. Unë jetoj me të në një shtëpi. Para se të dilte nga shtëpia më tha se do të dilte me shoqen e saj të ngushtë E-në. Vdekjen e saj e saj e mora vesh nga televizionet dhe kam shkuar menjëherë në polici. Atje më thanë se nuk kishte vdekur asnjë vajzë me emrin Aurora. Por, e kuptova që ishte Lola jonë vetëm nga mbiemri", shprehet me lotë në sy, B. Oskian, vajza e hallës së Aurorës.


Si e morët vesh për ngjarjen?

Ngjarjen e kam marrë vesh nga televizionet. Sapo kam marrë vesh se çfarë po ndodhte menjëherë kam shkuar në polici. Atje askush nuk po më jepte njeri informacion se çfarë kishte ndodhur dhe më thanë se nuk ka vdekur asnjë vajzë. Unë e bindur që ishte Lola ime e njoha nga mbiemri, pasi është i rrallë në Shqipëri.

Familja e Aurorës jeton këtu apo jashtë vendit dhe çfarë origjine keni?

Ne me origjinë të largët jemi nga Armenia, por jemi me kombësi Shqiptare. Familja e Aurorës ka jetuar gjithmonë në Shqipëri.

Si ishte një ditë e Aurorës? A ju ka treguar më parë se çfarë lidheje ka me personat që ka qenë në makinë?



Viktima Aurora Oskian



Banasa ku jetonte Aurora Oskian

Aurora ishte shumë e thjeshtë. Dita e saj ishte vetëm punë, shpi dhe kafe me shoqërinë. Bënte një jetë shumë të thjeshtë. Nuk e di se çfarë shoqërie ka pasur me ata persona, pasi nuk më fliste shumë për shoqërinë e saj. Kam dëgjuar vetëm për

shoqen e saj të ngushtë E-në, por jo se e njihja nga afër.

Ku punonte Aurora dhe a ishte e fejuar?

Jo, Lola nuk ishte e fejuar. Për disa vite ka punuar në një kompani "Call Centre", por për momentin nuk ishte në punë, pasi më kishte thënë se do të ndryshonin ambient.

Pjesa më e madhe e të shtënave kanë qenë në vendin ku ishte ulur Aurora dhe për këtë dyshohet se mund të ketë qenë edhe objektivi. Cili është reagimi juaj për këtë?

Nuk besoj se mund të ketë qenë ajo. Lolën e njoh që të vogël. Ajo nuk ishte vajzë që binte në dërrasë të kalbur. Nuk ka qenë asnjëherë e përfshirë në trafikim e drogës, siç mund të përfillet. Ne jemi mi një familje e shtresës së mesme dhe e thjeshtë. Nëse do të kishte qenë ndryshe, babai i saj nuk do të punonte roje.


Po më pas, a keni takuar njeri në polici?

Jo, nuk kam shkuar të takoj më asnjëri. Madje as sendet e saj personale nuk i kam marrë dhe nuk e di se çfarë ka pasur me vete.

Po me E-në, shoqen e Aurorës e keni takuar? Keni folur me të?

Jo, as nuk e kemi takuar dhe as nuk kemi folur me të sepse as ne dhe

DESHMIA



"Dëgjova breshëri dhe rënkimet e shoqes"

E.Gj., vajza që shpëtoi për mrekulli pa marrë asnjë plumb gjatë atentatit, ka qenë e para që ka lajmëruar policinë për ngjarjen. Vajza, e cila sapo ka dëgjuar të shtënat me armë që shkonin në drejtim të makinës "BMW", menjëherë ka dalë që aty për t'u fshehur ku të mundej. Burime nga grupi hetimor, bënë me dije, se në dëshminë e saj, vajza është shprehur se nuk ka mund të shohë se kush ka qenë personi që ka qëlluar mbi ta, pasi është mundur t'i fshihej të shtënave. "Sapo kam dëgjuar të shtënat jam ulur poshtë sediljes dhe nuk kam mundur të shoh asgjë. Më pas kam hapur derën e makinës dhe jam larguar nëpër lagje, të futesha ku të mundja. Madje nuk di as se sa autorë kanë qenë. Kam dëgjuar një breshëri të shtënash dhe disa rënkime të shoqes sime", ka thënë E.Gj në deklaratën e saj.

as ajo nuk jemi në gjendje për momentin. Jam e sigurt që ajo ndihet e traumatizuar nga ajo që ka parë. Dhe ishte fati i saj që shpëtoi. Edhe pse nuk i njoh personat e tjerë, më vjen shumë keq për këtë që u ndodhi. Dhe të plagosurit (Elvis Gaçaj) i uroj shërim.



SIGURIA


I plagosuri Elvis Gaçaj ruhet me policë në Spitalin e Traumës



Elvis Gaçaj, 40 vjeçari i cili ishte personi i dytë që shpëtoi nga atentati që iu bë afër Lulishtes "I Maji", ruhet me policë në Spitalin e Traumës. Në katin e dytë tek "Ortopedia", para derës ku ndodhej i shtruar Gaçaj ndodheshin dy efektive policie. Burime nga policia thanë për gazetën se 40-vjeçari nuk është në masë arresti, por efektivet blu qëndrojnë pranë tij për të parandaluar ndonjë ngjarje tjetër të mundshme. Ndërsa, në dhomën e tij, herë pas here shihje persona të shumtë të cilët kujdeseshin për të. pjesa më e madhe e të pranishmëve ishin shokë e miq të 40 vjeçarit. I pyetur nga gazeta, ai shprehet se nuk është në gjendje të tregojë asgjë nga ajo se çfarë ndodhi. Tashmë, Gaçaj ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

Rrëfimi

Shoku i Aurorës: "Me të kam folur pak ditë më parë"



E.Sh, shoku i fëmijërisë së Aurorës, në një intervistë për "Shqiptarja.com" rrëfen kujtimet që ka prej saj. Ai tregon se 10 minuta para se të ndodhte ngjarja ka kaluar pranë Lulishtes "I Maji" dhe ngjarjen e ka marrë vesh nga një shoku i tyre i përbashkët. "10 minuta para se të ndodhte kjo që ndodhi kam kaluar tek Lulishtja "I Maji", pasi kam pirë kafe aty pranë. Me Aurorën ishim shokë që fëmijë dhe çdo hall e ndanim bashkë", thotë për gazetën djali me iniciale E.Sh.

Sa kohë keni që njiheni me Aurorën?

Me Aurorën njihemi që të vegjël. Jemi shokë që në fëmijëri. Unë nuk jetoj më këtu, por me të nuk i kisha shkëputur lidhjet.

Si e more vesh për ngjarjen dhe kur është hera e fundit që e keni takuar?

Në Tiranë jam kthyer para pak ditësh dhe jam takuar edhe me Aurorën. Biseduam dhe kujtuam fëmijërinë. Kurse ngjarjen e kam marrë vesh nga një shok. Para 10 minutash se të ndodhte ngjarja unë kam kaluar aty.

A ju ka treguar Aurora për personat që ndodhej në makinë, çfarë lidheje kishte me ta? Po ju a i njihnit ata persona?

Jo, nuk më ka treguar asgjë. Personalisht nuk i njoh, por kam dëgjuar se viktima (Klevis Rugova) ishte e përfshirë në punë të pista. Dhe në morg kur isha shihja shumë djem të rinj, shokë të tij që vinin aty. Disa prej tyre i kam parë disa herë.



Makina e qëlluar nga breshëria e kallashnikovit

VIDEO/GJENDET NE LUMIN E LANES KALLASHNIKOV I MASKRES



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

Arma gjendet në lumin Lanë 29 gëzhoja në vendngjarje


Në banesën e viktimës policia gjen një sasi kokaine

Policia e Tiranës dhe pulumbarë të RENE-s gjetën dhe në Lumin Lanë armën me të cilën u qëllua në drejtim të makinës tip "BMW" seria 5 dhe me targë AA 675 JS. Pas kërkimeve të imtësishme rreth zonës ku ndodhi ngjarja mbrëmjen e djeshme, policia gjeti armën tip Kallashnikov të hedhur brenda në Lanë. Burime nga policia thanë se arma u dërgua në laborator për të vërtetuar nëse arma e gjetur është pikërisht arma e cila i mori jetën 29 vjeçares Aurora Oskian, 23 vjeçarit Klevis Rugova, si dhe plagosi 40 vjeçarin Elvis Gaçaj.

GËZHOJAT E GJETURA

Në vendin e ngjarjes, grupi hetimor gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale 29 gëzhoja nga dy armë të ndryshme. 23 prej këtyre gëzhojave ishin të armës kallashnikov e cila është përdorur nga persona ende të paidentifikuar. Ndërsa, 6 prej gëzhojave ishin të një arme tip pistolette të tipit "TT". Burime nga grupi

hetimor, bënë me dije se pistoleta është përdorur nga 40 vjeçari Elvis Gaçaj, i cili ishte shofer i BMW-së. Gaçaj i është kundërpërgjigjur autorit me pistoletë, por pa e plagosur atë. Po ashtu, policia njofton se efektivet blu janë duke kqyrur ende vendin e ngjarjes dhe zonat për rreth saj, për të zbardhur prova të tjera të cilat mund të çojnë në identifikimin dhe vënien në pranga të autorit.



Arma e gjetur në Lanë

GEJNDËT KOKAINE NË SHËTËPI

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e 23 vjeçarit Klevis Rugova, grupi hetimor gjeti një sasi kokaine e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale. Lidhur me këtë, në pyetje u morën edhe familjarë të 23 vjeçarit. Sipas policisë, viktimë Klevis Rugova

nuk figuron si një person me precedent të mëparshëm penal, por njëjshi si një person i përfshirë në trafikun e drogës, si përdorues dhe shpërndarës. Pikërisht për këtë gjë, burime nga policia bënë me dije se makinat me të cilat ai udhëtonte, ndaloheshin për t'u kontrolluar.

Hetimet



XHENSILA KODRA
TIRANE

Pistat e policisë hakmarrja ndaj Gaçajt ose droga

Policia vë në dispozicion 10 mijë euro kush jep informacion për autorin/ët e ngjarjes. Polica heton të shkuarën e viktimave

Objektivi i atentatit të ndodhur dy ditë më parë në rrugën "Ramiz Kovaçi", në Tiranë dyshohet se mund të ketë qenë 40 vjeçari Elvis Gaçaj. Sipas policisë dhe nga verifikimet e kryera deri më tani, ky person rezultoi si një person me precedent të mëparshëm penal për një sërë veprash si "Vrasje", "Grabitje", si edhe për vepra penale në fushën e narkotikëve. Burime nga grupi hetimor, bëjnë me dije se kjo është një nga pistat në të cilat janë përqendruar hetimet në lidhje me atentatin. Të njëjtat burime sqaruan se Gaçaj dyshohet se ka kryer një vrasje jashtë Shqipërisë, ndërsa më 4 Shtator të vitit 2008 ai është arrestuar si person i dyshuar për plagosjen e një shtetasi të identifikuar si Sefer M. Në atë kohë ngjarja ka ndodhur në 26 Korrik të vitit 2008. Po në 2008, ky person i ka mbijetuar edhe një atentati me eksploziv, në afërsi të shkollës "Petro Nini Luarasi", në Tiranë. Ndërsa,



I plagosuri Elvis Gaçaj

në 1992, kur Gaçaj ka qenë vetëm 18 vjeç, në mënyrë aksidentale ka vrarë me thikë shokun e tij. Për këtë krim, ai ishte dënuar me 14 vite burg dhe dënimin e ka përfunduar para disa vitesh. Gjithashtu, një nga pistat për të cilat

është duke u hetuar ngjarja e dy ditëve më parë është edhe ajo e trafikut të drogës. Sipas burimeve, kjo pasi policia ka pasur informacion se viktimë Klevis Rugova dhe i plagosuri Elvis Gaçaj ishin të përfshirë në



Viktima Kevin Rugova

trafikun e drogës.

SHËPËRBLIMI

Policia e Tiranës ka vendosur në dispozicion një shumë prej 10 mijë eurosh për të gjithë personat që japin informacion për autorin

► POLICIA

Nga verifikimet e kryera deri më tani, Gaçaj rezultoi person me precedent të mëparshëm penal për një sërë veprash penale, si "Vrasje", "Grabitje", dhe vepra penale në fushën e narkotikëve

► SALI BERISHA

Sali Berisha, nëpërmjet një postimi në Fb, sipas "Qytetarit dixhital", shkruan se atentati i ndodhur tek Lulishja "1 Maji" ishte ndaj mikut të Ministrisë të Brendshme, Saimir Tahiri

NGJARJA

Mbrëmjen e së enjtes, rreth orës 20:00 Tiranë u trondit nga breshëria e plumbave të cilat u derdhën drejt makinës BMW seria 5 ku udhëtonin Elvis Gaçaj 40 vjeç (drejtuesi i makinës), Aurora Oskian 29 vjeçe, banuese në Tiranë (pasagjere në sedijen e parë) e Kevin Rugova 23 vjeçar (pasagjer në sediljen e pasme). Po ashtu, e ulur në sedijen e pasme ka qenë edhe një vajzë tjetër me iniciale E.Gj e cila sapo ka dëgjuar të shtënat ka dalë nga makina për t'i shpëtuar atentatit. Si pasojë e të shtënavë, gjetën vdekjen e menjëhershë Aurora Oskian, Kevin Rugova dhe u plagos drejtuesi i mjetit Elvis Gaçaj. Ai u transportua me urgjencë për në spital nga disa banorë të lagjes. Shumica e plumbave ishin të përqendruara në krahun e Aurora Oskian. Ndërsa, shoqja e saj e ngushtë, vajza me iniciale E.Gj arriti t'i shpëtonte plumbave për mrekulli.

apo për autorët e ngjarjes së ndodhur në afërsi të Lulishës "1 Maji". Po ashtu, në dispozicion është vendosur edhe një numër kontakti, ku personat të cilat kanë informacion mund të kontaktojnë në numrin e telefonit 069 41 15 502.

TE ARRESTUARIT

ELTON QYNO
VELOPOJE

Ish-kryetari i komunës Velipojë Nikollë Marku është arrestuar gjatë pasdites së djeshme, për akuzën e "Shpërdorimit të detyrës". Kanë qënë forcat e policisë së Shkodrës ato që kanë vënë në pranga ish-kryekomunarin, ku bashkë me të janë arrestuar dhe 8 persona të tjerë që janë ish-anëtarë të KRRT Velipojë. Operacioni për arrestimin e ish-zyrtarëve të kësaj komune është iniciuar nga prokuroria e Shkodrës, e cila pasi ka marrë lejen në gjykatë ka urdhëruar policinë të kryejë arrestimin e 9 personave, mes të cilëve edhe shtetasin Nikollë Marku. Nga hetimi ka rezultuar se këta shtetas, në disa mbledhje të KRRT Velipojë, në vitin 2010, kanë dhënë, në kundërshtim të plotë me ligjin, leje në favor të një subjekti të vetëm ndërtues, "Fishta" sh.p.k, kompani kjo që rezultoi të jetë e Seit Fishta, ky i fundit ish-kandidat për deputet i PS në Shkodër.

50 LEJË PËR FISHTËN

Nga veprimet hetimore të njësies Task-Forcë është zbuluar se ish-kryekomunari Marku ka firmosur 50 leje në favor të biznesmenit Fishta. Madje vetëm në dy mbledhje, ku në 13 gusht 2010 ai ka firmosur 14 leje ndërtimi për subjektin Fishta, ndërkohë në mbledhjen e 28 dhjetorit 2010 ka miratuar 18 leje ndërtimi. Një veprim të tillë ish-kryekomunari e ka kryer

Nikollë Marku
ish-Kryetar i Komunës Velipojë, në cilësinë e ish-Kryetarit të Këshillit të Rregullimit të Territorit (KRRT) Velipojë,

Gjovalin Bregna
ish-anëtar i KRRT, Velipojë

Marash Keçi
ish-anëtar i KRRT, Velipojë

Dilë Ndoka
ish-anëtar i KRRT, Velipojë

Lekë Simoni
ish-anëtar i KRRT, Velipojë

Filip Kercunga
ish-anëtar i KRRT, Velipojë

Enver Kotri
ish-anëtar i KRRT, Velipojë

Gëzim Sala
ish-anëtar i KRRT, Velipojë

Emiljan Dashi
ish-anëtar i KRRT, Velipojë

me ish-anëtarët e këshillit si Gjovalin Bregna, Marash Keçi, Dilë Ndoka, Lekë Simoni, Filip Kercunga, Enver Kotri, Gëzim Sala dhe Emiljan Dashi. Pritet që brenda 48 orëve 9 të arrestuarit të dalin para gjykatës së Shkodrës për

Ish-komunari në pranga, akuza për 50 leje ndërtimi

Nikollë Marku dhe 8 ish-anëtarë të KRRT akuzohen për shpërdorim detyre



Nikollë Marku, ish-Kryetar i Komunës Velipojë

t'u njohur me masën e sigurisë, të kërkuar nga prokuroria. Ndërkohë që mësohet se gjatë procesit hetimor, të arrestuarit kur janë marrë në pyetje kanë mohuar akuzën e "Shpërdorimit të detyrës", pasi mendohej se kanë bërë

shkelje në ligjin e urbanistikës.

KUSH ËSHTË SEIT FISHTA

Seit Fishta, njihet në qytetin e Shkodrës si biznesmen ndërtimi. Ai ka ndërtuar dhjetëra pallate në Shkodër dhe dhjetëra të tilla në zo-

nën turistike të Velipojës dhe Shëngjinit. Fishta për shumë vite është marrë vetëm me biznes, ndërkohë që kohët e fundit ai është aktivizuar në politikë, duke aderuar pranë forcës politike Partia Socialiste. Madje në zgjedhjet elektorale

PRETENCA

Katër vite burg për gjyqtaren Parashqevi Ademi



Prokuroria e Krimeve të Rënda kërkon 6 vjet burg për gjyqtaren e Lezhës, Parashqevi Ademi, të akuzuar për korrupsion pasiv. Sipas njoftimit zyrtar, Prokuroria kërkon dhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të funksioneve publike për pesë vjet. Gjithashtu, prokuroria kërkoj edhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të funksioneve publike për 5 vjet. Procesi është zhvilluar me procedurën e gjyqimit të shkurtuar dhe, duke qënë se e pandehura përfiton uljen 1/3 të dënimit, në përfundim, prokuroria për Krime të Rënda kërkon dënimin përfundimtar me 4 vjet burgim.

të 2013 Seit Fishta, ka garuar për ngjyrat e PS, për t'u bërë deputet por nuk ka arritur të fitojë. Nëse Tom Doshi, jep dorëheqjen nga mandati i deputetit atëherë Fishta bëhet automatikisht deputet i Parlamentit të Shqipërisë.

LAJME SHKURT



Itali, kapet grupi i drogës, koka ishte shqiptar

Policia italiane ka zbuluar një grup që merrej me trafikimin e lëndëve narkotike, duke vënë në pranga pesë persona. Policia në Lecco thotë se bëhet fjalë për një grup që kishte një veprimtari shumë komplekse në shitjen e drogës. Një drejtuesit e grupit ishte shqiptari Françesk Meçaj. Sipas policisë, Meçaj është shumë i rrezikshëm dhe agresiv dhe zhvillonte trafik drogës në stacionin e trenit Lecco-Milano. Mësohet se shumë njerëz të rinj në përpjekje për të blerë drogë nga ky grup, kryen grabitje, ndërsa vajzat ofronin edhe seks në këmbim të drogës.

Tiranë, e përplas makina sapo kalon trafikndarësen

Një aksident me pasojë vdekjen ka ndodhur orët e mbrëmjes së djeshme në kryeqytet. Një person i paidentifikuar ka humbur jetën pas përplasjes nga një automjet në afërsi të zonës së njohur si kthesa e Kamzës. Këmbësori, sapo ka kërpyer trafikndarësen në rrugë, është përplasur nga një mjet targat apo drejtuesi, i të cilit nuk bëhen ende të ditura. Mësohet se trupi i pajetë i personit është dërguar në morgun e Tiranës ku pritet të identifikohet nga të afërmit apo familjarët. Ndërkohë, policia po kryhen hetimet e nevojshme për të zbardhur motivet e aksidentit.



Korçë, dy të ndaluar, gjenden 880 kg kanabis në fshatin Dushar

Policia e Korçës ka ndaluar edhe dy persona të tjerë të lidhur me sasinë prej 880 kg kanabis të sekuestruar në një operacion të pak ditëve më parë. Njëri prej të ndaluarve është Alket Zaimaj, i shpallur në kërkim për prodhim dhe shitje lëndësh narkotike, ndërsa personi tjetër është 16-vjeçar O.Gj., i cili është shogëruar me akuzën e moskallëzimit të krimi. Në operacionin e koduar me emrin "Prita", policia e Korçës kapi 880 kilogramë hashash dhe arrestoi 4 persona. Aksioni u realizua në afërsi të fshatit Dushar, në Bashkinë e Maliqit, ku është sekuestruar lënda narkotike e ambalazhuar në 30 thesë.


Vrasje për një fjalë, 17-vjeçari qëllohet me thikë pas sherrit

Një ditë pas vrasjes së 17-vjeçarit Romario Kodra nga fshati Qatrom, kanë reaguuar ashpër edhe bashkëfshatarët e tij. Sipas tyre, viktima ishte një ndër djemtë më shembullor të fshatit, ndërsa nuk flasin kështu për autorin e vrasjes, tashmë të arrestuar. Njëri prej shokëve të Romarios tregon se ngjarja e rëndë nisi fillimisht në ambientet e lokalit të fshatit, ku viktima dhe autori ishin duke luajtur "Playstation". "Viktima me autorin nuk kishin lidhje fare. Konflikti nisi duke luajtur "Playstation" dhe më pas ajo që ndodhi ishte çarja me thikë", thotë një dëshmitar.

Mirditë, gjenden rrënjë kanabis, në pranga kryeplaku

Rreth 1.890 rrënjë kanabis sativa të kultivuar në 4 parcele janë asgjësuar nga policia e Lezhës në fshatin Malaj të Mirditës. Sipas policisë, në pranga ranë Gentian Skeja, Fran Vokri dhe Agron Vokri. Burime nga uniformat blu kanë bërë të ditur se Skeja konsiderohet si përgjegjësi

kryesor për mbijelljen e bimëve, ndërsa dy të tjerët për mbështetje dhe moskallëzim të krimi. Në banesën e Fran Vokrit, u gjetën 7 kg lëndë narkotike. Ndërkohë, Agron Vokri rezultoi se është kryeplak i fshatit Malaj dhe ka toleruar të riun Skeja për mbijelljen e kanabisit.



Vajza italiane: 2 shqiptarë më përdhunuan 4 herë

Një vajzë italiane është rikthyer për herë të tretë në gjykatë për të dëshmuar mbi përdhunimin që i ka ndodhur në vitin 2012. Agresorët janë shqiptari Gramos Ngjela, 25 vjeç, marokeni Youssef Sardy dhe një tjetër shqiptar, i cili nuk është identifikuar. Vajza ka treguar se Ngjela ishte një nga tre përdhunuesit

që e ndaloj. Ajo, 17-vjeçe në atë kohë, tregon se u kthye në shtëpi me hundë të gjakosur dhe gjunjë të lënduar. Vajza rrëfen se ishte kthyer në një viktimitë të rregullt për grupin e përdhunuesve, pasi ata e përdhunuan adoleshenten katër herë në dy muaj. Herën e fundit, përdhunimi ndodhi në amfiteatrin e Neretos.

"Prokurorët që zvarrisin hetimet do dënohen"

Adriatik Llalla vendos nën monitorim prokurorët në rrethe: Të hapen zyrat për të dëgjuar ankesat e qytetarëve



MONITORIMI

Aktiviteti i Prokurorisë vijnë të ketë vëmendjen kryesore nga faktorë vendas dhe ndërkombëtarë. Ka shumë partnerë seriozë që mbështesin institucionin tonë dhe e konsiderojnë si një ndër paradhomat kryesore për zhvillimin të Shqipërisë



VONESAT

Nga kontrollat periodike të Prokurorisë së Përgjithshme janë konstatuar raste të vonesave të pajustificuara në veprimet hetimore nga prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore



Për këtë Llalla, në fjalën e tij, u ritheksoi drejtuesve të Prokurorisë nevojën për komunikimin në të hapur me qytetarët, pasi, sipas tij "i gjithë funksioni ynë është në përbushje të interesave të ligjshme të publikut".

Prokuroria është vënë shpesh në qendër të vëmendjes së medias dhe debatit public, përsa i përket zvarritjes së çështjeve.

Vonesa këto që sjellin dhe rritjen e mungesës së besimit të qytetarët për vënien në vend të drejtësisë. Për këtë pikë Llalla ka kërkuar nga drejtuesit e prokurorisë që të vendosin programe konkrete për të eliminuar këtë problem. "Nga kontrollat periodike të Prokurorisë së Përgjithshme janë konstatuar raste të vonesave të pajustificuara në veprimet hetimore

nga prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore. Çdo rast i konstatuar do të jetë pjesë e vlerësimit vjetor si për personat përgjegjës, ashtu edhe për drejtuesit e prokurorisë", u shpreh Llalla. Por përsa i përket prokurorëve që nuk do të respektojnë këtë kërkesë, kreu i akuzës ka paralajmëruar masa ndëshkuese. "Qytetarët presin zgjidhje ligjore në një kohë sa më opti-

male dhe për këtë arsye ne do të vijmë të marrim masat ndëshkuese për prokurorët që nuk respektojnë parimet bazë të punës", tha Llalla në fjalën e tij. Në vijim të këtij argumenti, Prokurori i Përgjithshëm bëri prezent edhe faktin që ka shumë ankesa nga qytetarë të ndryshëm, të cilët nuk priten në takime nga drejtuesit lokalë. "Ju duhet të dëgjoni qytetarët, të merrni shqetësimet e tyre mbi punën e prokurorisë dhe t'i shqyrtoni me strukturat përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme. Është shumë e rëndësishme që të dëgjohet zëri i qytetarëve, pasi i shërben përmirësimit të vazhdueshëm të punës sonë", nënvizoi Llalla.

Në një deklaratë të dhënë për mediat u bë e ditur se "në takimin e drejtuesve të Prokurorisë ishin pjesëmarrës edhe drejtuesit e Njësisë Task-Force kundër Korrupsionit, me të cilët Llalla zhvilloi një takim të veçantë, ku u analizua situata aktuale e çështjeve në zhvillim, si edhe u theksua mbështetja e plotë që Prokurori i Përgjithshëm ofron për veprimtarinë e tyre specifike".

LAJME SHKURT



Qarkullonte me pistoletë me silenciator, pranga 25 vjeçarit

Një i ri nga kryeqyteti është arrestuar nga policia për armëmbajtje pa leje. Në pranga ka rënë 25 vjeçari Ari Haxhiu. Sipas uniformave blu të policisë, 25 vjeçari Ari Haxhiu u arrestua në flagrancë nga shërbimet e komisaritit numër 5 në rrugën "Demokracia". Bëhet me dije se Haxhiu u gjet në pistoletë me mbishkrimin "Broening/5 Patent Depose", një krëhër me 6 fishekë dhe një zhurme lëshues silenciator, të cilat u sekuestruan nga efektivat e policisë në cilësinë e provës materiale.

Tahiri në Akademinë e Policisë: Nuk krahasoheni me të rinjtë e tjerë


Ministrit të Punëve të Brendshme, Saimir Tahiri, morri pjesë dhe në ceremoninë e diplomimit të punonjësve të rinj të Policisë së Shtetit në Akademinë e Policisë. "Kemi mbyllur një proces arsimimi disa mujor, që ma do mendja nuk ka qenë i lehtë për secilin prej jush, tha gjatë fjalës së tij Tahiri. "Dallimi nga jeta normale e një të riu dhe një të reje, jeta e përditshme, qoftë kjo në bankat e fakultetit, qoftë kjo në punë, as krahasohet me atë që keni bërë ju në Akademinë e Policisë për t'u arsimuar dhe është akoma më larg, me jetën e re që fillon për ju që nesër e tutje", shtoi ministri.

Berat, qëllojnë me kallashnikov, policia arreston katër persona

4 persona të afërm me njëri-tjetrin janë arrestuar pasi akuzohen se kanë qëllua ma armë automatik në ajër. Sipas policisë së Beratit, në pranga kanë rënë Florjan, Sajmir, Brikën dhe Elton Qato. Arrestimi i tyre u bë pasi në vendin e quajtur "Kthesa e



Roshnikut" kanë qëlluar në ajër me armë zjarri tip "kallashnikov". Në vendngjarje është gjetur dhe sekuestruar arma dhe 33 gëzhoja. Materialet i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, për veprat penale "Prodhim dhe mbajtje paleje e armëve luftarakë dhe municioneve" dhe "Prishja e qetësisë publike" të kryera në bashkëpunim".



Gjykata e Lartë: Prenga në burg, përbën rrezikshmëri të lartë

Gjykata e Lartë ka lënë në arrest me burg deputetin e Qarkut të Lezhës, Armando Prenga, me arsyetimin se përbën rrezikshmëri të lartë shoqërore. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është marrë nga pesë gjyqtarë. Në vendim është pasqyruar dhe një vendim pakice, që nuk pajtohet me masën "arrest me burg". Sipas mendimit të pakicës, "askush nuk mund t'i nënshtrohet masave të sigurimit personal, nëse në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova". Prenga, në një letër të shpërndarë për mediat, thotë se nuk ka qëlluar me armën në konfliktin për Lagunën e Patokut.

Armë, drogë dhe lëndë shpërthyes, arrestohet 30 vjeçari



Një 30 vjeçar është arrestuar nga Policia e Vlorës, pasi në banesën e tij u gjetën lëndë shpërthyes, armë dhe lëndë narkotike. I arrestuari është Roland Veizaj, banues në lagjen "4-heronjtë", të qytetit të Vlorës. Gjatë kontrollit në banesën e tij, policia sekuestroi një armë zjarri tip "Automatik model 56", një krëhër të mbushur me 30 fishekë të kalibrit 7.62 mm, 25 fishekë të tjerë të kalibrit 7.62 mm, 32 gr kanabis, e cila ishte e thërrmuar si edhe një kallëp tritolli, njëgjë kafe. Materialet u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Zbardhet vjedhja me armë e 4 personave në 2014-ën

Një ngjarje e ndodhur në nëntor të 2014, në afërsi të doganës greke në Kakavijë është zbardhur nga Policia e Gjirokastrës. 21 vjeçari, Spiro Kuqcka nga Ksamili, i cili dyshohet si autori kryesor i vjedhjes me armë të 4 personave, është ndaluar nga policia. Kuqcka dyshohet se në bashkëpunim me personatë

tjerë ka vjedhur me armë shtetasit E.R, 27 vjeç dhe E.R, 20 vjeç, të dy banues në fshatin Suk 2 të Fierit, A.C, 22 vjeç, banues në Suk 1, si dhe A.C, 26 vjeç, banues në Peguin. Gjithsej, këtyre 4 personave iu vodhën 5 aparate celularë, 370 Euro dhe 10.000 lekë. Kuqckës i sekuestrua 1 celular së bashku me kartën sim.

Rubrika

SHËNDETI

LEXIM I LEHTËSUAR

Për të ndihmuar njerëz në moshë të thyer rubrika "Shëndeti" botohet me gërmë më të madhe për të lehtësuar leximin

Për të kuruar sëmundjet e kockave sot përdoren shumë mënyra, tradicionale por edhe ilaçe të ndryshme që rekomandohen nga mjekët. Një studim i ri ka zbuluar se efekti që jep një ilaç që po përdoret prej 3 vitesh në SHBA ndikon në uljen e dhimbjeve të kockave. bëhet fjalë për acidin zoelidronik, i cili merret 1-2 herë në vit. Ky ilaç ende nuk ka ardhur në vendin tonë, por në Europë përdoret gjerësisht. Studimet tregojnë se shumë pacientë po i drejtohen klinikave më të njohura në SHBA dhe Europë për të marrë ilaçin. Acidi zoelidronik merret nëpërmjet venave dhe ndikon në forcimin e kockave, sidomos tek të moshuarit. Përpos këtij ilaci studimet thonë se, 15 ditë më pas duhet patjetër që të filloni të lëvizni. Këshillohet që çdo i moshuar por dhe personat e tjerë që vuajnë nga sëmundjet e kockave të të fillojnë me 20 minuta ecje në natyrë dhe më pas të bëjnë ushtrime stërvitore. "Kemi arritur në përfundimin se mutacionet e ndryshme gjenetike mund të ndikojnë në proteina e eshtrave ato veprojnë në një rrugë të përbashkët për ta shkaktuar sëmundjen e eshtrave, pra ndikojnë në atë se si proteinat sinjalizuese të quajtura faktori beta i transformimit të rritjes dërgohet në qelizat në eshtra. Ne tani e kemi një kuptim më të thellë për mënyrën se si mutacionet gjenetike të cilat ndikojnë në kolagjen dhe enzimat procesuese të kolagjen-it shkaktojnë eshtra të dobëta", - u shpreh një nga anëtarët e studimit Howard Hughes.

POR CILËT JANË FAKTORËT E SËMUNDJES

Një nga faktorët e sëmundjes së kockave është trashëgimia. Nëse prindërit apo gjyshërit tuaj vuajnë nga dhimbjet e kockave, atëherë ka një përqindje të lartë për të vuajtur kur të arrini moshën 40 vjeç. Një tjetër faktor tjetër është dhe peshja, pasi sjell dobësimin e kockave. Faktorë të tjerë janë edhe duhani dhe alkooli. Alkooli



Studimi

Si mund të kurohen sëmundjet e kockave

Përpos këtij ilaci studimet thonë se 15 ditë më pas duhet patjetër që të filloni të lëvizni

ndikon keq te hormonet që merren me rregullimin e kalciumit dhe pakëson formimin e kockës. Gjithashtu prish edhe thithjen e kalciumit. Duhani me nikotinën që përmban bëhet shkak për pakësimin e vitaminës D. Gjithashtu ka veti antiestrogjenike. Pakëson thithjen e kalciumit.

OSTEOPOROZA

Kockat tona janë ato që ruajnë disa organe të trupit tonë (zemrën, trurin), realizojnë lëvizjen, depozitojnë minerale dhe mbajnë në vetvete të ashtuquajturën palcën e kockës vendi ku prodhohen qelizat e gjakut. Janë të përbëra nga kristale të mineraleve si fosfori, kalciumi dhe magneziumi. Ka dy lloje qelizash, ato që formojnë kockën dhe ato që e treshin

kockën. Deri në moshën 20-25 vjeç dominante janë qelizat që formojnë kockën, më pas ato shkatërrojnë megjithëse kanë një ekuilibër mes tyre. Rritja e shkatërrimit pakëson sasinë e mineralit dhe kjo sjell thyerjen e kockës. Gjendja ku sasia e mineralit pakësohet shumë quhet Osteoporozë. Kjo është sëmundja më e shpeshtë metabolike e kockave ku mikroarkitektura e tyre dhe masa e kockës janë zvogëluar. Osteoporozja është një sëmundje e fshehtë. Nëse është krijuar osteoporozja vihet re dhimbje të belit dhe shpinës. Sidomos kockat e vertebrës janë shumë delikate. Edhe kockat e kyticit të dorës ndikohen. Tek tipi i dytë vihen re më shumë dhimbjet e kockave. Me rritjen e moshës rritet mundësia e thyerjes së kockave të legenit. Këto lloje thyerjesh janë tepër të rrezikshme për jetën apo për ta bërë të sëmurin të mos lëviz nga shtrati.



Studimi



Faktorët

Një nga faktorët e sëmundjes së kockave është trashëgimia. Nëse prindërit apo gjyshërit tuaj vuajnë nga dhimbjet e kockave, atëherë ka një përqindje të lartë për të vuajtur kur të arrini moshën 40 vjeç.



Mosha

Me rritjen e moshës rritet mundësia e thyerjes së kockave të legenit. Këto lloje thyerjesh janë tepër të rrezikshme për jetën apo për ta bërë të sëmurin të mos lëviz nga shtrati.

KËSHILLAT STUDIMET

• Përhapja

Nëpërmjet ushqimit përhapen më shumë se 200 sëmundje të shkaktuara nga mikroorganizma (baktere, viruse, kërpudha, prione, parazitë), substance kimike ose edhe agjentë fizikë



• Njerëzit

Njerëzit që jetojnë në varfëri janë më të pambrojturit nga rreziqet ndaj shëndetit me prejardhje nga ushqimet, por ndryshimet demografike dhe mjedisore, si për shembull plakja e popullsisë

• Shifrat

Në planin global, sëmundjet ne origjinë nga ushqimi vrasin çdo vit 2 milion njerëz, shumë prej të cilëve janë fëmijë. Në 2013, pati më shumë se 310.000 raste të sëmundjeve origjinë nga ushqimet



Ushqimet "e këqija"

Ja sëmundjet që mund të shkaktohen



Shkaktarët e sëmundjeve janë të shumtë, por asnjëherë nuk është menduar që edhe ushqimet ndikojnë për to. Sipas studimeve janë shumë sëmundje që vijnë nga ushqimet kryesisht me natyrë toksike dhe infektive. Ato shkaktohen nga bakteret, viruset, kërpudhat, prionet, parazitët ose substancat kimike që hyjnë në organizëm nëpërmjet ushqimit ose ujit të ndotur. "Këto sëmundje akute me origjinë nga ushqimet (shpesh quhen helmim ushqimor) shkaktohen nga ngrënia e ushqimit të kontaminuar nga bakteret, si për shembull salmonella, që ka disa përmbajtje të veçanta si (Campylobacter, Clostridium perfringens, Staphylococcus aureus, Bacillus cereus ose Escherichia coli). Nëpërmjet ushqimit përhapen më shumë se 200 sëmundje të shkaktuara nga mikroorganizma (baktere, viruse, kërpudha, prione, parazitë), substance kimike ose edhe agjentë fizikë.

Simptomatologjia e këtyre sëmundjeve varjon nga simptoma akute ose kronike, dhe nga diarreja në kancer. Në planin global, sëmundjet ne origjinë nga ushqimi vrasin çdo vit 2 milion njerëz, shumë prej të cilëve janë fëmijë. Në 2013, pati më shumë se 310.000 raste të sëmundjeve origjinë nga ushqimet të raportuara vetëm në Bashkimin Evropian të cilat sollën 322 vdekje. Çdo vit në BE raportohen më shumë se 85.000 raste salmoneloze, me një kosto prej më shumë se 3 miliardë euro", - thonë ekspertët e Institutit të Shëndetit Publik.

Epidemia e Escherichia Coli enterohemorragjike e vitit 2011 në Gjermani dhe Francë, që lidhej me filizat e ndotura të bimës trigonella foenum-graecum, çoi në 4000 raste në 16 vende, duke përfshirë 908 raste të sindromës së uremisë hemolitike, 55 vdekje, si dhe në humbje të vlerësuar prej 1,3 miliardë dollarësh për fermerët dhe industrinë.

SHKAKTARËT

Njerëzit që jetojnë në varfëri janë më të pambrojturit nga rreziqet ndaj shëndetit me prejardhje nga ushqimet, por ndryshimet demografike dhe mjedisore, si përshembull plakja e popullsisë, migracioni në rritje, emergjencat, ndryshimet klimatike dhe ngjarjet e jashtëzakonshme të motit – po vënë në rrezik gjithmonë e më shumë popullsinë. Ndryshimet e stilit të jetesës, – duke përfshirë urbanizimin, udhëtimet, ngrënia e më shumë ushqimeve jashtë shtëpisë dhe prirjet e reja ushqimore – gjithashtu po rrisin riskun ndaj sëmundjeve me origjinë nga ushqimet. Gjatë dekadave të fundit janë shënuar sfida të reja ndaj sigurisë ushqimore. Globalizimi i tregtisë së ushqimeve dhe kafshëve e ka zgjeruar më shumë gamën e ushqimeve në dispozicion të konsumatorëve dhe paraqet shanse për vendet eksportuese. Megjithatë, ai e bën zinxhirin e ushqimit më të gjatë e më kompleks duke krijuar një mjedis ku sëmundjet me origjinë nga ushqimet bëhen kërcënim dhe mund të përhapen më lehtë, duke lehtësuar transmetimin e patogjenëve në distancë. Problem gjithmonë e më i madh i sigurisë ushqimore po bëhet dhe Rezistenca Antimikrobiale që duhet të trajtohet në vijim. Për shembull, në vendet e BE-së, Salmonella dhe Campylobacter tregojnë një nivel të lartë rezistence ndaj antimikrobialëve të përdorur tek njerëzit dhe kafshët.

NDIKIMI

Droga ndihmon për të luftuar Leuceminë

Një studim i publikuar në revistën "Nature", ka zbuluar se droga ndihmon në luftën ndaj sëmundjes së Leucemisë. Një grup shkencëtarësh kanë testuar drogën tek 3 persona që vuanin nga kjo sëmundje dhe kanë zbuluar se pacientët patën një përmirësim brenda 15 ditëve, përmirësim që mjekëve u është dashur më shumë se një vit për tu marrë me të. Fillimisht shkencëtarët po studionin ndikimin e drogës tek diabeti, por më pas u zbuluar se është sëmundja e Leucemisë ajo që luftohet. Studimi nuk do të njihet nga organizatat e shëndetësisë për shkak se shkencëtarët kanë përdorur sasi të lartë droge për terapinë.

ARSYET

Pse duhet të parandaloni pirjen e duhanit

Kancer i mushkërve, sëmundje të qarkullimit të gjakut, problemet me sytë, probleme të qarkullimit të gjakut, dëmtime të fetusit të grave shtatzëna, dëmtime në shëndetin e familjarëve të tjerë janë disa nga pasojat e prirjes së rregullt të duhanit. Shumë duhanpirës nervozohen nga propaganda lidhur me dëmet që vijnë nga duhani përmes reklamave, fushatave të sensibilizimit publik dhe presioneve shqetësuese të të afërmeve apo familjarëve. Nëse ndaloni në mënyrë të menjëhershme duhanin, mungesa e nikotinës mund të shkakttojë një rritje të madhe të dëshirës për të dhe simptoma të tjera si irritim, nervozizëm dhe humbje të përqendrimit.

Siria, konflikti i radhës mes Perëndimit e Rusisë

Ndërsa bota priste dialog ushtarak Rusi-SHBA për krizën, avionët nisën sulm të njëanshëm

DENIS MINGA
TIRANË

Ndërhyrja e fundit e avionëve rusë në Siri duke goditur jo vetëm objektiva të ISIS, por edhe të luftëtarëve në frontin anti-Asad, që mbështeten nga SHBA, ka shkaktuar një tension të ri mes dy superfuqive ushtarake. E ndërsa presidenti rus Vladimir Putin ndodhej në Nju Jork në Asamblenë e OKB-së pas 10 viteve mungese, ushtria ruse, nga ana tjetër, përgatitej për të kapur në befasi SHBA-në dhe aleatët e saj, duke nisur fushatën e sulmeve ajrore në Siri. Ndërsa gjithë bota priste fillimin e një dialogu ushtarak mes Rusisë dhe SHBA për krizën siriane, papritur avionët ushtarakë të Moskës ndërmarrin sulmin e njëanshëm ajror mbi Siri. Me pretekstin e goditjes së objektivave të terroristëve të ISIS, Rusia ka goditur dhe kampet e luftëtarëve kundërshtarë të regjimit të Asad, që prej kohësh stërviten nga CIA. Kjo lëvizje e papritur e Moskës ka kapur në befasi Uashingtonin, që gjatë



javëve të fundit kishte intensifikuar kontaktet për një dialog ushtarak të përbashkët me Rusinë në luftën e përbashkët kundër ISIS. Menjëherë SHBA ka krijuar frontin diplomatik me aleatët e saj: Francën, Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Katarin, Arabinë Saudite dhe Turqinë, duke i kërkuar Moskës të përqendrohet në sulmet e saj vetëm mbi objektivat e ISIS. Gjithashtu, fronti i udhëhequr nga SHBA ka shprehur

shqetësimin e thellë për praninë e njëanshme ushtarake të Rusisë në Siri dhe veçanërisht për sulmet ndaj luftëtarëve kundër regjimit të Asadit.

Nga ana tjetër, Pentagoni është duke parë mundësinë e përdorimit të forcës ushtarake për të mbrojtur rebelët anti-Asad të stërvitur nga CIA nëse ata do të bien sërish pre e sulmeve të Rusisë.

Tensioni i rikthyer mes SHBA-së dhe Rusisë, më i rëndi

që pas konfliktit të Ukrainës, ka për shkak kryesor presidentin e Sirisë Bashar Al-Asad. Ndërsa Moskë deklaroi se regjimi i tij është i domosdoshëm për luftën ndaj ISIS dhe stabilitetin në Siri, SHBA-të kanë një qëndrim krejt ndryshe. Uashingtoni mendon se Asadi është një nga shkatërrarët kryesorë të krizës disavjeçare siriane dhe një zgjidhje e mundshme politike për vendin nuk duhet të përfshijë më emrin e Bashar Al Asadit. E ndërsa Uashingtoni dhe Moskë ishin shumë pranë në dukje të një dialogu ushtarak mes tyre me qëllimin e përbashkët shkatërrimin e ISIS, ndërhyrja e papritur e avionëve rusë Sukhoi-34 ka prishur skenarët e bashkëpunimit, ndërsa ka detyruar SHBA-të të mendojnë një tjetër skenar rreth krizës siriane. Uashingtoni kishte menduar krijimin e një fronti të përbashkët me pjesëmarrjen edhe të Rusisë kundër ISIS dhe më pas zgjidhjen politike, ku aktorët kryesorë do të ishin pikërisht luftëtarët e lirisë anti-Asad, të cilët sot janë vënë nën shënjestër të avionëve rusë. Nga ana e tij, presidenti rus Putin, me sulmin e menjëhershëm ndaj kundërshtarëve të Asadit,



Barak Obama dhe Vladimir Putin

ka dhënë mesazhin se nuk do të pranojë asnjë zgjidhje politike në Siri pa presidentin aktual. Burimet ushtarake ruse kanë bërë të ditur se ofensiva ajrore do të zgjasë të paktën 3 muaj duke nënkuptuar qëllimet serioze të Rusisë për të qenë aktori kryesor në vendin e trazuar prej vitesh tashmë.

Ashtu siç veproi në Gjeorgji dhe Ukrainë, Rusia tregoi edhe një herë tjetër se, në rastet e krizave, veprimet ushtarake të shpejta janë më efektive sesa negociatat politike. Ashtu si në dy rastet e mëparshme, Rusia e kapi të papërgatitur Perëndimin përpara përket veprimeve ushtarake dhe, pavarësisht kritikave dhe embargoeve, Moskë arriti të merrte atë që synonte, dominimin e saj. Edhe këtë herë Rusia synon që, duke

përfutur nga lëvizja e ngadaltë e makinerisë ushtarake të Perëndimit, të përfitojë sa më shumë terren, duke vendosur e para flamurin e saj. Pas kësaj lëvizjeje shahu të Moskës, pritet lëvizja e Perëndimit me në krye SHBA, si në aspektin ushtarak, ashtu dhe në atë diplomatik. Konfliktet e fundit kanë treguar se Perëndimi është më i aftë në rrafshin diplomatik, por shumë i ngadaltë në atë ushtarak. Një hapësirë kjo, e mbushur me shumë shpejtësi nga Rusia e Vladimir Putinit. Se si do të përfundojë konflikti në Siri është shumë e vështirë ta parashikosh, por ajo që mund të thuhet tani është se sapa ka nisur një konflikt i ri me Perëndimit dhe Rusinë. Kush do të triumfojë kësaj radhe? Le të presim

LAJME SHKURT



Mali i Zi ndërton kamprefugjatësh në kufi me Shqipërinë

Mali i Zi po përgatit terrenin për ardhjen mundshme të refugjatëve nga Lindja e Afërt. Në afërsi të vendkalimit kufitar Bozhaj, që nga Mali i Zi çon për në Shqipëri, ka filluar rregullimi i hapësirës ku në rast të valës së refugjatëve do të ndërtohet një kamp me tenda. Pas mbylljes së kufirit nga ana e Hungarisë dhe Kroacisë, refugjatët nga Lindja e Afërt pritet të udhëtojnë nga Mali i Zi drejt Kroacisë, për të arritur më tej në vendet e Bashkimit Europian. Një kamp i mundshëm për refugjatët do të ndërtohet në Gjirin Nikine, që ndodhet rreth tre kilometra nga vendkalimi kufitar Bozhaj.

Koalicioni anti-ISIS apel Rusisë: Ndalo sulmet ajrore!

Disa pjesëtarë të koalicionit anti-ISIS, i kanë bërë thirrje Rusisë të ndalojë sulmet ajrore që po godasin opozitën siriane dhe popullsinë civile. Në një deklaratë të përbashkët, Shtetet e Bashkuara, Britania, Turqia dhe shtete të tjerë paralajmërojnë se bombardimet e Moskës nuk do të bëjnë gjë tjetër veçse do ta nxisin edhe më shumë ekstremizmin. Lëvizja e tyre vjen në kohën kur Francois Hollande u takua me homologun rus Vladimir Putin mes frikës se Moskë po ndërmerr "sulme ajrore pa dallim" mbi militantët në Siri. Sipas Shtëpisë së Bardhë, Rusia është duke goditur opozitarët sirianë.

Gjermani, autoritetet dëbojnë nga shtëpitë qirramarrësit

Një 56-vjeçar gjermanë do të dëbohet nga shtëpia e saj, për shkak se aty do vendosen emigrantët. Gabrielle Keller, e cila jeton prej 23 vitesh në një shtëpi me qera në qytetin Eschbach, tha se se është skandal që të nxjerrësh nga shtëpia një qirramarrës.



Autoritetet i kanë lënë afat 56-vjeçarës Keller deri në fund të vitit për t'u larguar nga shtëpia. Kryebashkiaku Mario Schafke tha se nuk kanë zgjidhje tjetër. Ndërsa, pak ditë më parë, një infermiere u nxor nga shtëpia e saj, ku jetonte prej 16 vitesh, për të njëjtat arsye. Sipas të dhënave, 280 mijë emigrantës kanë mbërritur në Gjermani brenda shtatorit.



Telefonat e Blair për Gaddafin: Gjej një vend të sigurt dhe fshih

Tony Blair ka këshilluar Muammar Gaddafin që të dorëhiqet dhe të gjejë "një vend të sigurt", gjatë kohës kur protestat kishin nisur në të gjithë Libinë. Mesazhet e publikuara nga Departamenti amerikan i Shtetit përmbajnë transkriptim të një telefonate të ish-kryeministrit britanik me diktatorin e Libisë më 25 shkurt 2011. Biseda është transkriptuar nga këshilltarja e tij, Catherine Rimme, e cila ia ka dërguar këshilltarit të Hillary Clinton. Rimme tha se Blair dha një mesazh të fortë se dhuna duhet të merrte fund dhe se Geddafi duhet të dorëhiqet për t'i hapur rrugën krijimit të një qeverie të re.

Obama: Nuk mund t'ia dal dot i vetëm përballë tragjedi

Barack Obama i dërgoi vendit të tij një tjetër mesazh për të reflektuar sërish mbi nevojën e ndryshimit të ligjeve të armëmbajtjes, pas tragjedisë në një kolegj të Oregonit, ku numërohen të paktën 10 viktimat. "Duhet të bëjmë diçka për të ndryshuar gjërat, por unë nuk mund t'ia dal

dot i vetëm dhe shpresoj që gjatë mandatit tim presidencial të mos vij më në Oregon për të bërë ngushëllimet e rastit", tha kreu i shtëpisë së Bardhë. "Jemi i vetmi vend modern në botë ku ëphtuajse çdo muaj shohim të tilla ngjarje. Këto ngjarje janë kthyer në rutinë", theksoi Obama.



Indonezi, avioni zhduket nga radarët


Një avion indonezian pasagjerësh që transportonte 10 persona ka humbur kontaktin me kontrollorët e fluturimit, teksa ndodhej mbi ishullin Sulauesi. Avioni, në pronësi të kompanisë ajrore vendase të Indonezisë, Aviastar, humbi kontaktet disa momente pasi u ngrit nga pista e aeroportit Masamba. Sipas autoriteteve lokale, mjeti fluturoi po udhëtoje drejt kryeqytetit provincial Makasar me tre anëtarë të ekuipazhit dhe shtatë pasagjerë në bord, mes të cilëve dy fëmijë. Kjo është një tjetër ngjarje që çmon reputacionin e sigurisë së avionacionit indonezian.



Fan Noli



Enver Hoxha



Faik Konica

AMANE TI

TRI LETRAT E NOLIT PER ENVER HOXHEN: LUTEM PRANONI ESHT RAT E KONICES

Me 8 nëntor 1945, Fan Noli i shkruante Enver Hoxhës dy mesazhe, njëri prej të cilëve ishte telegram. Ai i lutej që të pranonte eshtrat e Konicës në atdhe, duke i theksuar se ky qe amaneti i tij i fundit. Noli i sqaron Hoxhës se shpenzimet e udhëtimit do të përballoheshin nga miqtë dhe adhuruesit e Konicës në Amerikë. Pas këtyre dy mesazheve me tekst thau se të njëjtë, Hoxha duket nuk ka kthyer asnjë përgjigje positive Nolit. Kjo vërtetohet nga një letër e tretë e Nolit për Enver Hoxhën, pa datë, por sipas ngjarjeve që shpjegojnë në letër, përkon me verën e '46, kur po intensifikoheshin përpjekjet për ta pranuar Shqipërinë në OKB. Edhe në këtë letër të tretë të Nolit përsëritet kërkesa për ti pranuar eshtrat e Konicës në atdhe. Nuk ka sërish, ndonjë të dhënë për një përgjigje të Hoxhës mbi këtë temë, por fakt është se eshtrat e Faik Konicës u kthyen

në atdhe vetëm në vitin 1995 dhe u varrosën pranë kodrave të liqenit. Më poshtë sjellim tre mesazhet e plota të Nolit për Hoxhën ku flitet mbi këtë temë.

DOKUMENTET

Letër Enver Hoxhës
Tiranë, Shqipëri 8 nëntor 1945
Dëshira e fundit e Faik Konicës ishte që të prehej në atdhe, në Shqipëri. Kini mirësinë të na njoftoni kur do të ishte e përshtatshme që të sillleshin eshtrat e tij me nderimet përkatëse si kampion i pavarësisë së Shqipërisë.

Të gjitha shpenzimet do të përballohen nga miqtë dhe adhuruesit e tij në këtë vend.

Shqiptarët e këtij vendi do ta vlerësonin një përshëndetje të shkurtër nga ju për ditën e Pavarësisë së Shqipërisë.

F. S. Noli

LETËR GJENERAL-KOLONEL ENVER HOXHËS

Tiranë 8 nëntor 1945

Unë përfitoj nga ky rast t'ju kujtoj përsëri në qoftëse ju jeni apo jo të përgatitur të merrni në të ardhmen e afërm eshtrat e Faik Konicës me qënë se ay mbahet në qeli këtu shpenzimet të paguara...

Faik Konitza pat shfaqur dëshirën e fundit që të varroset në vendlindjen e tij. Stop. Lutemi na njoftoni kohën më të përshtatshme që të bëni nderimet e pranimit të trupit të luftëtarit të parë për Indipendencën e Shqipërisë. Stop. Miqtë dhe adhuruesit e tij do të kujdesen këtu për përcjelljen e trupit të tij. Stop. Do të jenë jashtëzakonisht të lumtur shqiptarët e këtushëm po t'i dërgoni ditën e pamvarësisë një përshëndetje të shkurtër./Stop/ Imzot Noli

MESAZH ENVER HOXHËS

Kryeministrit Enver Hoxha /1946/ (?)
Tiranë
Shqipëri

Pata një bisedim me kryetarin vepronjës të delegacionit të Shteteve të Bashkuara zotin Herschel Johnson më parë ambasador në Suedi Stop. Pyetjes sime briske në qoftë se Qeveria e Shteteve të Bashkuara do të mbështesë kërkesën shqiptare

për anëtarësi në Kombet e Bashkuara ay i dha një përgjigje evazive dhe që nuk të angazhohen Stop. Gjatë zhvillimit të bisedimeve, ay përmendi reputacionin e traktatave nga qeveria juaj, e cila më dha rastin mua të shpjegoj pikëpamjen tuaj në bazë të rezolucionit të dalë nga Kongresi i Përmetit stop. Në fund unë tërhoqa vërejtjen e tij mbi absurditetin e pretendimeve greke mbi Epirin e Veriut stop. Unë përfitoj nga ky rast t'ju kujtoj përsëri në qoftëse ju jeni apo jo të përgatitur të merrni në të ardhmen e afërm eshtrat e Faik Konicës me qënë se ay mbahet në qeli këtu shpenzimet të paguara... Stop Lutemi përgjigjuni mbi këtë pikë para 4 korrikut kur mbledhet Kuvendi vjetor i Vatrës stop. Përgjigja e juaj do t'i japë mundësi Kuvendit të vendosë për një rrugë ose për tjetrën.

Peshkop Fan Noli
26 Blagden At
Boston Mass.



Pamje nga gëhimet arkeologjike në Kishën e Asomatit



Fragmente vizatimesh nga muret e Kishës së Asomatit



Fragmente pikturash nga muret e Kishës së Asomatit

Historia e kishës së Asomatit lidhet me Shën Klementin e Ohrit

Tempulli i shekullit të 3-të në Velçë të Vlorës

Intervista, flet arkeologu Skënder Muçaj: Tempulli në themelet e kishës së shekullit të 9-të. Ja artefaktet

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Thesare arkeologjike, sapo janë zbuluar në fshatin Velçë të Vlorës. Janë dhjetë artefakte të përziera si kohë historike me njëri-tjetrin. Zbulimi më i hershëm i përket një tempulli të shekullit të 3-të, dhe mbi rrënojat e tij zbulohen artefakte të pazakonta të kishës së Asomatit, që lidhet me Shën Klementin e Ohrit.

Në këto foto që botohen ekskluzivisht nga "Shqiptarja.com" shohim se çfarë ka zbuluar ekspedita e drejtuar nga arkeologu i njohur Skënder Muçaj. Gurë të mëdhenj antikë me dekoracione, që i përkasin periudhës helenistike të shekullit të 3-të; një copë e madhe fasade prej mermeri ku duket e gdhendur një palmë, "shenja të një qytetërimi që kanë qenë i njëllojtë me Italinë fqinje të asaj kohe", sipas arkeologut. Muret e tempullit janë kthyer në rrënoja dhe mbi to në shekullin e 9-të është hedhur themeli i kishës së Asomatit.

Kisha e Asomatit, e shenjuar si një zbulim i një vëzhgimi arkeologjik sipërfaqësor të vitin 2011, ka qenë vetëm maja e ajsgjergut të këtyre zbulimeve arkeologjike.

Ndërsa ekspedita arkeologjike e përqendruar në zonën e lumit të Vlorës mbyllet në fund të shtatorit, arkeologu Skënder Muçaj është kthyer në Tiranë me një pjesë të konsiderueshme të artefakteve që presin të restaurohen, konservohen dhe studiohen. Pjesa më e madhe e gërmimeve është bërë kryesisht në kishën e Asomatit që është në fshatin Velçë. Muçaj rrëfen se "kjo kishë ka ngjallur kuriozitetin që në vitin 2011, kur u zbulua për herë të parë nga kërkimet sipërfaqësore në terren". Sondazhet dhe gërmimet në këtë kishë, sipas tij, nisën nga toponimia dhe nga disa të dhëna të periudhës bullgare që lidhen me Shën Klementin e Ohrit. U mendua të bëheshin kërkime për të parë, nëse kjo kishë shkonte në atë periudhë e Mbretërisë Bullgare në shek-



Arkeologu Skënder Muçaj

Ekspedita
Ishte përqendruar në zonën e lumit të Vlorës. Arkeologu Skënder Muçaj është kthyer në Tiranë me një pjesë të konsiderueshme të artefakteve që presin të restaurohen, konservohen dhe studiohen

ullin e 9-të apo ishte një kërkim siç ndodhte edhe me kishat e tjera që janë ndërtuar në shekullin e 13-14-të. Por materiali ishte i gjithë nëntokë, sepse ishte zbuluar vetëm çatia e kishës. Gërmimet e ekspeditës së drejtuar nga Skënder Muçaj nxorën në dritë artefakte të pazakonta. "U kuptua se kisha ishte ngritur mbi një të tempull të periudhës helenistike të shekullit të 3-të rrëfen arkeologu i njohur, i cili na rrëfen se

çfarë doli në dritë duke gërmuar hap pas hapi deri në themelet e kishës e rrënuar. E këto zbulime në bregun e Vlorës e deri në Kamenicë kanë qenë plot surpriza...

Profesor, çfarë zbulimesh sollët nga gërmimet në kishën e Asomatit?

-Kur nisën gërmimet dolën në dritë ambientet e saj. U zbulua se kisha ishte ruajtur mirë. Kishte dalë në sipërfaqe në një lartësi deri në 2 metra e ca. Zbulimi i këtyre mureve nxori në dritë se kisha e Asomatit nuk ishte njëqëfishtë, por ishte një kishë shumë më e madhe.

Pse pati interes pikërisht kjo kishë, para se të bëheshin sondazhet?

-U nisëm nga toponimia e vendit që quhet Asomat, por edhe nga disa të dhëna që vijnë të Mbretërisë Bullgare që lidhen me Shën Klementin e Ohrit. U mendua që të bëheshin kërkime për të parë nëse kjo kishë shkonte deri në atë periudhë e mbretërisë bullgare në shekullin e 9-të apo ishte një ndërtim i kohëve të vona, siç ndodhte me pjesën më të madhe të tyre, që janë datuar në shekullin e 13-14-të. U pa se kisha ishte ndërtuar mbi një rrënojë më të vjetër që ishte e shekullit të tretë të periudhës helenistike.

Të dhënat e deritanishme datojnë që kisha i takon shekullit të 9-të dhe vërtetohet që kjo kishë lidhet me periudhën e aktivitetit të Shën Klementit të Ohrit, peshkop i Velikës ose i Velçës, për arsye se Velça është i njëjti toponim me Velikën. Për këtë kanë folur studiues të ndryshëm, disa e vendosin në territorin e Maqedonisë, disa pranë lumit të Vardarit, disa rreth Ohrit dhe nuk ka një përcaktim të saktë deri më sot se ku u emërua si peshkop Klementi i Ohrit. Ai u bë u bë peshkop pasi kishte hapur dhe shkollat e shumta, ku kishte përgatitur një numër të madh priftërinjsh, rreth 3500 veta në krahinën e Kutmicevicës,



e lokalizuar në territorin e Shqipërisë së sotme duke filluar nga liqeni i Prespës, Ohrit deri në Jon e Adriatik me një trekëndësh që fillon andej dhe përfundon në Vlorë.

Për çfarë përmendet në histori shën Klementi i Ohrit?

-Klementi i Ohrit është një pasues i Krishtëritimit tek sllavët. Ky i çoi më tej mësimet e krishtëritimit së bashku me shenjtorët e tjerë sllavë, siç është Shën Naumi, Shën Angjellari, etj.

Shën Naumi ka origjinë sllave?

-Nuk flitej në atë kohë për etnicitetin nëse kanë origjinë sllave apo nuk kanë origjinë sllave, por janë ata shenjtor që punuan për popullsinë sllave për të t'u çuar fenë e krishterë. Sllavët deri në atë kohë ishin paganë. Është fakt se ata kanë vepruar në territorin tonë. Dhe për t'u varrosur po ashtu janë varrosur në territorin tonë. Shën Klementi është



e kishës së Asomatit



Fragment i zbuluar nga tempulli i shekullit të 3-të, mbi të cilin është ndërtuar kisha e Asomatit



Shkronja në muret e tempullit



Pamje nga dalja në dritë e tempullit të shekullit të 3-të të periudhës helenistike nën themelet e kishës së Asomatit

varrosur në Ohër, edhe Shën Naumi po duhet se është varrosur në Liqenin Ohrit. Edhe për shën Gorazdin dhe Shën Angjellarin gojëdhënat dhe reliket tregojnë se janë varrosur në afërsi të kishës së Ballshit. Një pjesë e eshtrave të tyre janë në muzeun e Onufrit të Beratit. Ato janë sjellë në aty herë sipas gojëdhënave që në shekullin e 14-të bashkë me librat dhe reliket e tjera.

Ju thatë se kisha ishte ndërtuar mbi tempull, dihet kush është tempulli?

—Jo tempulli i parë nuk njihet. Materiali i plotë ende nuk është gjetur, se nuk kemi shkruar deri në kërkimin e fundit. Por ky material që ka dalë tregon qartë që kemi një tempull dhe se kujt shekulli i përket. Janë gjetur dy tempuj të tillë, njëri këtu në Asomat, tjetri në Krofisht. Ai është i ruajtur më mirë. Është ruajtur baza e tij. Edhe mbi të është ndërtuar një kishë. Ka nevojë për gërmime të mëtejshme, do t'i vijojmë vitin tjetër. Mendoj

që pas këtyre gërmimeve të kthehet në vend pelegrinazhi kisha e Asomatit. Deri tani këtu kemi përpunje mes aktivitetit të Shën Klementit dhe të dhënave që dalin nga gërmimi.

Nga vjen toponimi Asomat?

Asomatit është fjalë që vjen nga greqishtja "pa trup" që ka kuptimin vetëm për engjëjt. Deri në këtë periudhë në këtë territor Shën Mëhilli dhe Shën Gabrieli nuk njiheshin, por njihet Shën Asomati. Është një territor i gjerë që e ka përdorur Shën Asomatin. Dhe në Athinë kisha e fundit në Greqi është e shekullit të 11-të. Kjo saktëson se cilin shekull i përket kisha e Asomatit. Ende nuk janë gjetur të gjitha objektet, se ka shumë punë, por materiali që kemi në dorë, tregulla dhe tulla tregojnë se objektet e kishës janë të datueshme të shekullit të 9-të. Nga vizatimet kemi gjetur se ka gjurmë të një vizatimi që i përket vetëm shekullit të 9-të-10-të, s'e nuk ka ndryshim të madh.

Nobeli për letërsinë

259 propozime, Kadareja zbrit nga kreu i listës



Akademia Suedeze, ende nuk e ka treguar datën se kur do të ndahet Nobeli për Letërsi. Është bërë traditë që këto çmime të ndahen në mesin e tetorit. Kështu që mendohet të jetë data 15 tetor ose java që pason pas kësaj date. Zëdhënësit e Akademisë së Çmimit Nobel kanë dhënë vetëm numrin e kandidatëve të propozuar. Janë 259 emra të propozuar nga shtëpitë botuese, por nga ky numër tani është mbërritur në një listë më të ngushtë, nga do të zgjidhet fituesi. Ismail Kadare disa vite me radhë favorizohej për çmimin në krye të listës, sivjet është më i spostuar në listë. Vitin e kaluar Kadare printe në krye me Haruki Murakamin, shkrimtarin japonez. Vetë Murakami mbetet ende në krye të listës. Ai vlerësohet shumë nga kritika për veprat "Pylli norvegjez" apo "E dashura ime Sputnik" dhe mbetet një nga favoritët për Nobelin. Të tjerë emra në listën e ngushtë për Nobel janë shkrimtarja Svetlana Alexievich nga Bellorusia, Philip Roth dhe shkrimtari sirian Adunis. Vitin e kaluar çmimin Nobel për Letërsi e mori Patrick Modiano, shkrimtari francez.

Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- "Luftë" në Tiranë, 29 plumba marrin 2 jetë, autori 17 vjeç!
- Vrasësi që i shpëtoi për herë të dytë atentatit, ja precedentët
- Videolajm/ I ftuari e puth në buzë gazetaren gjatë intervistës live
- Prifti: Gati të dëshmoj në favor të qeverisë në arbitrazhin kundër DIA-s
- Cili është gabimi i Bleonës?! Kjo sjellje nuk i shkon për shtat një dive!
- Rinis regjistrimi nga e para i pronave, kush rrezikon ta humbasë
- Kapet 'Ariu' me pistoletë silenciator nëpër Tiranë, 6 fishekë në krehër
- VIDEO LAJM/ Gruaja dhuhet barbarisht në mes të Tiranës
- Gjendet ne lumin e Lanes kallashnikov i maskës ne Tirane
- Shqipëri-Serbi ndeshje me tension? Gazetari serb: E vdekur, nuk ka garë

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- "Luftë" në Tiranë, 29 plumba marrin 2 jetë, autori 17 vjeç!
- Rinis regjistrimi nga e para i pronave, kush rrezikon ta humbasë
- CEZ, 6 kompani që plaçkëten shqiptarët janë regjistruar
- Videolajm/ I ftuari e puth në buzë gazetaren gjatë intervistës live
- Rezultati i dobët, nga 803 policë fitojnë vetëm 60 me mbi 70 pikë

VIDEO T MË TË KLIKUARA DJE

Afrim me Metën? Sali Berisha: Marrëdhëniet i kemi njësoj

Viora "kampione" e falimentimeve në Shqipëri, 31% të totalit


Videolajm/Publikohet këngë e re për Kombëtaren para sfidës me Serbinë

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AiREPORT që shkarkohet falas

SONDAZH I DITES

Jeni dakord me protestat kundër rihapjes se bunkerëve të komunizmit për qelime turistike?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampanjave të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



1.234 | 214.842
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

DYLBER BALLA
TIRANE

350 policë për serbët tifozyt protestojnë për Vuçiçin e Ballistin

Zv. kryetari i Federatës Serbe të Futbollit: S'ka rëndësi fitorja, ishalla kthehemi gjallë

VUÇIÇ

"Sa më përket mua, ende nuk kam vendosur, unë jam marrë vesh me Ramën që të shkojë atje, por po e shoh që ai ka ftuar Thacin edhe të tjerët" ka thënë kryeministri i Serbisë për vizitën në Elbasan.

HELMIMI

"Nuk kemi asnjë frikë për helmim. Nuk është hera e parë që unë jam pjesë e delegacionit përfaqësues. Ne nuk shkojmë në vendet ku luan kombëtarja për të gatuar ushqimet tona", tha kuzhinieri Simanic.

BALLISTI

Mediat serbe i janë gëzuar vendimit për ndalimin e Ismail Morinës - Ballisti. 'Supersports' shkruan se "Kush do ta ngrejë tani dronin? Provokuesit shqiptar i mbyllin dyert në stadium".



PRECEDENTI

Zyrtare, Meha rikthehet me gol Lorik Cana në fushë ndaj Serbisë

Trajneri i kombëtares, Gianni De Biasi sot do të zyrtarizojë rikthimin e Alban Mehës. Ftesa për Mehën është konfirmuar edhe nga mediat turke. Rikthimin fantazisti e ka bërë me gol, Alban Meha ka shënuar për Konyaspor në fitoren jashtë fushë përballë ekipit të Trabzonsporit me rezultatin 1-2. Lorik Cana do të jetë në fushë në ndeshjen ndaj Serbisë pas një jave, lajmi konfirmohet në mënyrë indirekte nga klubi francez. Mbrojtësi kuqezi është grumbulluar nga trajneri Der Zakarian për sfidën e së shtunës në Ligën e Parë franceze në fushën e Nicës duke lënë të kuptohet se dëmtimi u la pas.

të ndonjë hoteli për ndonjë konferencë por, ju lutem... jo në stadium, jo një njeri që qëndroi indiferent në stadium kur në kor u thirr "vritni shqiptarët", dhe për këtë fajësoi

shqiptarët??. Ndërsa ndalimin e Ballist Morinës për të qenë në stadium, grupimi e cilëson si "absurditet, ky është servilizëm i pashoq karshi kërkesave të serbëve, dhe për më tepër

është i paligjshëm. Anëtarë në fjalë, nuk ndiqet penalisht, nga asnjë institucion kompetent ligjor dhe ndalimi i tij është shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut" shprehen ata.

EUROPA LEAGUE/ RACIZMI NË NDESHJEN SKËNDERBEU-LOKOMOTIVA

Rusët kërkojnë falje, UEFA nis hetimet

INCIDENTI

Thirrjet

Delegati polak ka regjistruar të gjitha thirrjet e tifozëve dhe do t'i paraqesë në raportin e përgatitur. Ultasit e Lokomotivës thërrisin në gjuhën serbe, vrisni shqiptarët e Kosova është Serbi.

Lokomotiva

"Ne i kërkojmë ndjesë Skënderbeut dhe tifozëve të tyre për atë që ndodhi në stadiumin tonë. Ne garantojmë se ata që janë fajtorë të këtij akti do të dënohen sipas ligjit të Federatës Ruse".

Lokomotiva e Moskës ka dënuar thirrjet anti shqiptare në ndeshjen ndaj Skënderbeut. Lokomotiv u bën thirrje tifozëve të qëndrojnë të bashkuar kundër veprimeve diskriminuese dhe poshtëruese.

"Ne i kërkojmë ndjesë Skënderbeut dhe tifozëve të tyre për atë që ndodhi në stadiumin tonë. Ne garantojmë se ata që janë fajtorë të këtij akti do të dënohen sipas ligjit të Federatës Ruse.

Ne do të marrë masat e nevojshme për të parandaluar veprime të tilla të ndodhin në të ardhmen. Tifozët rusë në ndeshjen e djeshme brohorisnin në stadium "Vritni shqiptarët". Lokomotiva e Moskës nuk do të i'a hedh paq vetëm me një kërkesë për për falje, pasi thirrjet raciste ndaj ekipit të Skënderbeut në përballjen me Lokomotivën e Moskës do të jenë në raportin e delegatit të UEFA-s, polakut Mihal Lickjeviç sipas mediave ruse. "Sport-Express.ru" shkruan se delegati polak ka regjistruar të gjitha thirrjet e tifozëve dhe do t'i paraqesë në raportin e përgatitur. Ultasit e Lokomotivës thërrisin në gjuhën serbe, vrisni shqiptarët dhe Kosova është Serbi duke kujtuar ngjarjet e Beogradit. Sipas rregullores UEFA-s, Lokomotiva e Moskës rezikon mbylljen e disa tribunave të stadiumit dhe nëse përsëritet mund të mbyllë dyert për të gjithë në takimin e radhës dhe të gjatë klubit organizator. Vendimi do të merret në mbledhjen e Komisionit të Disiplinës dhe Etikës në UEFA. Ndërsa përsa i përket ndeshjes presidenti i Skënderbeut, Takaj deklaroi "Pak e nga pak po fitojmë eksperiencë. Djemtë u paraqitën shumë mirë dhe bënë një ndeshje të madhe, por fati na mohoi rezultatin. Jam krenar për këta djem që dhanë më të mirën në një klimë aspak të qetë", përfundoi presidenti i Skënderbeut, Ardan Takaj.



DERBI

Tirana sfidon Partizanin sonte në "Qemal Stafa"

Sonte në orën 20:45 do të zhvillohet ndeshja e parë derbi për këtë edicion mes Partizanit dhe Tiranës në stadiumin kombëtar. Sfidat priten me mjaft interes, pasi rivaliteti është historik për sundimin e kryeqytetit dhe duelli për titull këtë edicion pritet që të jetë i ashpër, në radhë të parë për të sjellë trofeun në kryeqytet pas 5 vitesh në Korçë. Në stadium pritet që të jenë të pranishëm një numër shumë i madh tifozësh nga të dy kampet, ndërsa policia ka marrë masa të rrepta që gjithçka të shkojë sa më qetë. Pas 5 takimeve të luajtura, bardheblutë renditen në vendin e 6, 7 pikë e distancuar nga kreu dhe 5 pikë nga rivalët e kuq.

BARÇA-SEVILJA

Enrike: Të përfitojmë nga përplasja e rivalëve

Trajneri i Barcelonës Luis Enrique me shumë mungesa në formacionin e parë, para ndeshjes së sotme me Sevillan shprehet se duhet të fitojmë duke përfutur nga përplasja Real-Aletiko. "Jam i surprizuar nga renditja e Sevillas në pjesën e poshtme të tabelës. Duke njohur trajnerin dhe futbollistët e kësaj skuadre, mendoj se pozicioni i saj gënjën. Duhet të përfitojmë nga përplasja e rivalëve me njëri-tjetrin. Luiz Suarez është shfaqur në nivel të lartë që kur ka mbërritur të Barcelona, edhe pse statistikisht sidomos në ndeshjet e tij të para ngrinin pikëpyetje".

TIFOZËT NË HETIM

FSHF i ka dorëzuar Policisë së Shtetit emrat e 12.500 tifozëve që do të jenë të pranishëm në stadiumin "Elbasan Arena" në ndeshjen përballë Serbisë më 8 Tetor. Tashmë policia, por edhe organet e tjera ligjzbatuese do të nisin hetimin e atyre që do të kenë fatin që të shohin nga afër sfidën e shumëpritur. Policia nuk do të lejojë të hyjë në stadium dhe do të ndalojë, çilido person që nuk e ka emrin në këtë listë të FSHF-së.


KUNDËR RAMËS

Përmasë një letre të hapur, grupimi më i madh mbështetës i kombëtares shqiptare "Tifozat Kuqezi" deklaroi se ftesa ndaj Vucic është provokim ndaj lojtarëve që mezi shpëtuat të gjallë, prandaj shprehen ata, çfarëdo ngjarje e pakëndshme, si pasojë e veprimeve tuaja, përgjegjësia dhe turpi do të bien ekskluzivisht mbi ju. "Ju lutem, mos luani me ndjenjat tona! Ju lutem mos na provokoni. Mos i hidhni benzinë zjarrit. Nuk duam t'i urojm mirëseardhje një njeriu i cili kurrë nuk ka qenë miku jonë, nuk është miku jonë, nuk dëshiron të jetë miku jonë dhe kurrë nuk do të bëhet miku jonë. Nuk do ju perzheshim në ftesat që mund t'i bënit për në oborrin e kryeministrit apo



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHET TË NXINI 41 KUTI



HORIZONTAL


- Janë mbretit.
- Janë të gënjeshtërit.
- Në krye të radhës.
- Riparonte traktorë dikur (sigla).
- Veqpar ndryshe.
- Mund të jenë kulture.
- Fundi i një samurai.
- Mbyllin traktatë.
- Një që shkruan për të geshur.
- Një garë mes cowboy.
- Eshhtë adhurim për idhuj.
- Një... dollar.
- Thomas Alva shpikës i famshëm.
- Kënga pa kufij.
- Janë kub për vëllim të tilla.
- Mundi pa zë.
- Eshhtë transporti si kamion.
- Në atë vend.
- Zanore për kakao.
- Eshhtë ai që ka bërë veprën.
- Rrihen pa çifte.
- Ndizet në kufij.
- Steiger aktor.
- Magritte që qe piktor.
- Eshhtë nivel i kampionit.
- Një mund të jetë filmi.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË




- Eshhtë numri 3.
- Eshhtë marshi i... Aida-s.
- Një fjalë... frënge.
- Fillojnë rubrikën.
- Një pjesë e reostalit.
- Bëhet për zakon.
- Kufizojnë katetet.
- Në hyrje të Europës.
- Ente Informative Kombëtare.
- Nicole aktore.
- Janë mobilje për abat-jour.
- Një fjalë si patjetër.
- Derisa mbarojnë.
- I famshmi Pacino.
- Risi regjisor italian.
- Një pjesë e relacionit.
- Një shtet Afrikan.
- Pak torturuese.
- Një takim... ndërkombëtar.
- Një pjesë e dimensioneve.
- E famshme ajo e Pitagorës.
- Qendër në kaos.
- Kufizojnë takimet.
- Nagpur ndryshe.
- Transportojnë edhe maune.
- Ka forca speciale.
- Një bojë për printer.
- Andej nga fillimi.
- Janë tek në tuftë.
- Eshhtë shtyllë me vela.

FJALËKRYQI SPORTIV



PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV



HORIZONTAL

- Janë paret e peshkut.
- Janë ndeshje të fundit.
- Mbyllin takimin.
- Fillojnë torturat.
- Paguhet për shërbim.
- Eshhtë përfaqësuesja... luzitane.
- Mbyllin kuvendin.
- Marco, që ishte pirati i ciklizmit.
- Besim pa kufij.
- Një pjesë e ekstremitëve.
- Bëhen me trëhapësh në tabelë.
- Gjysmë aneksi.
- Luan në ekstreme.
- Casey në Moto Gp.
- Një profil... në kavaletë.
- Vitet pa kufij.
- I bëjnë tekanjozët.
- Tiulli i Bobby Charlton.
- Irlanda jetër.
- Fillojnë natën.
- Mohamed, që thirret Messi i Egjiptit.
- Tare te Lazio.
- Vegjim pa ekstreme.
- Rastisin në krye.
- Mbyllin një takim.
- Janë në modë.
- Oliver Stone.
- Fillojnë tatëpjetën.
- Ekstremit në zell.
- Dy anët e një elementi

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGË 1-9

6	9	1	2	3	5	7	4	8
5	7	4	1	6	8	2	3	9
3	2	8	4	9	7	5	6	1
9	4	6	3	1	2	8	5	7
2	3	7	8	5	9	4	1	6
8	1	5	6	7	4	3	9	2
1	8	2	5	4	6	9	7	3
7	5	3	9	8	1	6	2	4
4	6	9	7	2	3	1	8	5

8			5	6	4			2
		1		8		9		
5			1		9			7
			8	3	1			
	1		6	4	5		9	
		5			7			3
2	6		3	1	8		4	9
1	3	4	9		6	7	2	8

HOROSKOPI

DASHI



Duhet të mendoheni disa here para se të veproni gjatë kësaj dite. Keni për t'u ndier mirë gjatë gjithë kohës dhe do i harroni njërherë e mirë problemet e shkuarës. Beqaret do afrohen tej mase me një person qe me pare e kane anashkaluar. Ja qe ndonjëherë gërat ndodhin ashtu si nuk e pret. Ne planin financiar gjendja do ketë gozha për mirësi me ju do ndiheni te qete.

DEMI



Ju qe jeni ne një lidhje do keni 9 gjate gjithë kohës mbështetjen e yjeve sot. Çdo gjë ka për t'u ecur ashtu si keni dashur dhe do përjetoni momente te lumtura. Beqaret do fiksohen pas një personi dhe do bëjnë te mundur qe te fillojnë me te një lidhje te qëndrueshme. Do ja dlini mbanë me sukses. Gjendja financiare do përmirësohet me shume nga sa keni menduar.

BINJAKËT



Mos u tregoni shume idealeist gjate kësaj dite juve qe jeni ne një lidhje sepe situata mund te dalë tërësisht jashtë parashikimeve dhe do lëndohen pa mase. Beqaret duhet te tregohen te arsyeshëm sepe ne te kundërt mund te hidhen ne krahitë e personit te papërshtatshëm. Ne planin financiar do dini t'i bëni me kujdes llogaritë dhe gjendja do mbetet e kënaqshme.

GAFORRJA



Neptuni do ndikojë negativisht gjate kësaj dite ne jetën tuaj ne çift. Do kaloni momente goxha te vështira me personin qe keni ne krah. Beqaret ka mundësi te bien koke e këmbë ne dashuri me personin qe do i joshë duke e filluar me shpejt nga sa mendonin një lidhje te qëndrueshme. Ne planin financiar duhet te tregoheni sa me te matur qe te mundeni ne mënyrë qe te shmangni problemet.

LUANI



Jeta juaj ne çift do marre një këthesë mite me gjate kësaj dite. Keni për t'u ndier mirë gjatë gjithë kohës dhe do i harroni njërherë e mirë problemet e shkuarës. Beqaret do afrohen tej mase me një person qe me pare e kane anashkaluar. Ja qe ndonjëherë gërat ndodhin ashtu si nuk e pret. Ne planin financiar gjendja do ketë gozha për mirësi me ju do ndiheni te qete.

VIRGJËRESHA



Dite mjaft e animuar dhe e mbushur me emocione te këndshme do jete kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Shfrytëzojeni sa te mundni çdo sekonde pranë partnerit. Beqaret do jene me fat dhe ka mundësi te gjejnë personin e tyre te ëndrrave. Ne planin financiar gjithçka do ece mirë. Do arrihi te kryeni edhe disa investime te rëndësishme qe me pare nuk kishit mundur dot t'i bëni.

PESHORJA



Nuk do kuptoheni për asgjë sot juve qe jeni ne një lidhje dhe nga te dyja palët do mungojë toleranca. Dita do jete përgjithësisht e zymte. Beqaret do merren me disa probleme familjare dhe nuk do kenë koha te mendojnë për dashurinë. Ne planin financiar do i zgjidhin një e nga një te gjitha pengesat dhe do arrihi te stabilizojnë menjëherë situatën.

AKREPI



Dite e privilegjuar kjo e sotmja për ata qe janë ne një lidhje. Do merreni dhuratë dhe propozime mjaft interesante nga personi qe keni ne krah. Beqaret duhet ende te presin sepe sa sot nuk do arrijnë ta bëjnë për vete personin e tyre te ëndrrave. Ne planin financiar tregohuni vigjilente nëse nuk doni te keni probleme serioze. Investimet lërin për me vone.

SHIGJETARI



Dite e këndshme do jete kjo e sotmja për te dashuruarit. Do merreni vesh për çdo gjë me partnerin dhe do kishin hapet e duhura. Beqaret nuk duhet te krijnë iluzione te kota vetëm nga fjalët e bukura qe mund t'u thotë dikush sepe do zhgënjehen pa mase. Me shpenzim tregohuni vigjilente ne çdo momente ne mënyrë qe te mos keni probleme serioze.

BRICJAPI



Te nxitur nga planetët ju do i shprehni edhe me tepër ndjenjat gjatë kësaj dite. Partneri gjithashtu do ju surprizojë pa fund ne çdo moment. Beqaret nuk do jene gati te ndryshojnë statusin dhe nuk do i shfrytëzojnë ftesat qe do ju bëhen. Gjendja e financave pritet te jete shume here me e qëndrueshme se disa dite me pare. Do dini t'i bëni me kujdes llogaritë.

UJORI



Tregohuni te kujdesëshem sot me ato qe do i thoni partnerit tuaj pasi ne te kundërt çdo gjë do jete keq. Ai nuk do jete ne humor dhe nuk do mendojë dy here para se te marre vendime jo te pëlqyera prej jush. Beqaret do enden sa andej këtej vetëm qe te mos qëndrojnë vetëm. Ne planin financiar nuk do keni aspak vështirësi, megjithatë bëni kujdes me shpenzimet.

PESHQIT



Sot do përjetoni emocione te palimagjueshme juve qe jeni ne një lidhje dhe kënaqësitë do jene pa fund. Shfrytëzojeni çdo sekonde. Beqaret do jene ne humor te mire dhe do bëjnë gjithçka për te filluar një lidhje me dike. Dëshirat do ju plotësohen. Ne planin financiar vështirësitë do jene te shumta. Kujdes me çdo hap qe do hidhni sepe nuk do ketë me kthim mbapa.

PËRGJIGJE

T	M	I	D	A	K	M	B	A	A
I	E	L	E	M	I	L	I	O	R
S	T	E	P	A	T	E	N	T	A
A	T	E	R	I	E	I	A	N	T
A	E	M	I	R	E	I	M	D	S
A	R	E	T	I	K	A	T	E	T
P	A	R	T	I	A	A	L	R	I
I	T	A	M	I	D	E	S	K	T
S	U	K	S	E	S	I	P	O	
T	R	U	S	T	R	U	B	I	N
A	A	A	S	E	I	K	T	A	
T	K	A	R	A	M	E	L	E	A

SHKRONJA
E NJËTË
PËR NUMËR
TË NJËTË

FJALËKRYQI I KRIPTOGRAFUAR

8	6	13	16	11	2	12	4	5	4		5	1
1	7	5	12		15	2	7		17	1	13	2
3	2	8		3	6	9	2	10	5	13	2	
6	7		3	6	9	2	4	2	8	1	11	5
7		3	5	9	2	8	1	11	5	4		15
2	15		7	1	13	6	11		6	7	5	
	5	3	2	8			11	13	5	7	1	8
9	9	1	10	5		2		1	3	5	9	2
1	9	8	2	4	1		6	9	4		5	
	2	4	7		17	1	9	9	2		8	9
6		5	2		16		2	7	6	11		2
15	Z	E	T	A		7	6	13	1	11	5	4

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Brahimi Shima, Aurel Pepa - Zv/kryeredaktor
Genc Kondi - Administrator i Përgjithshëm ; Admirina Peçi - Kryeredaktore e "Rilindasi" ; Politika: Brahimi Shima, Ekonomi : Lorenc Rabeta, Aktualitet: Elton Qyno,
Sociale: Sonila Isaku, Kulturë: Dhurata Hamzai, Sport: Dylber Balla, Design: Altin Aliaj, Erjon Ymeri, Website: Greta Malaj, Shpërndarja: Spiro Meshini cel: +355690608847

Departamenti i Marketingut:
Patricia Costantinescu
Cel: +355690606419
marketing@shqiptarja.com

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355690606421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASA shp, Rruga 5 Maji, Tiranë


PROJEKTI

Në Tiranë do të vij në fillim të nëntorit për të punuar një këngë me tekst të Rozana Radit dhe muzikë të Jurgen Shirës. Kënga do të regjistrohet në anglisht

Dorina TIKO:

MTV awards, synimi im në muzikë

Rikthehet pjesëtarja e band-it të parë shqiptar "Spirit Voice". Së shpejti në Tiranë me një projekt të ri muzikor



IZAURA NDOJ
TIRANË

Rikthimi i saj në skenën shqiptare ishte një surprizë për të gjithë fansat e band-it të parë shqiptar "Spirit Voice"! Por, ndryshe nga çfarë u përfol, Dorina Tiko u prezantua si soliste në "Kënga Magjike", për ti lënë radhën një tjetër surprizë! Në një intervistë për "Shqiptarja.Com", këngëtarja e cila prej vitesh është angazhuar në Amerikë në koncerte të ndryshe, rrëfen projektet e saj më të reja në Tiranë, por nuk lë pa zbuluar edhe synimin që ka gjatë këtij viti! Të depërtojë në MTV Awards, me një producent shumë të njohur në industrinë e muzikës në Amerikë, por që në këtë moment ajo na e lë surprizë. Në këtë rrëfim ajo na tregon dhe për familjen e saj dhe dashurinë e pakushtëzuar që ajo merr çdo ditë nga dy djemtë dhe bashkëshorti i cili e ka mbështetur në karrierën e saj si këngëtare.

Pas rikthimit pas shumë vitesh në "Kënga Magjike 2013" me këngën "Gjithmonë me ty", duket se po bluan diçka të madhe... Ku konsiston rikthimi juaj në Tiranë?

"Kënga Magjike 2013", një eksperiencë e mrekullueshme! Fal mikut tim, Ardit Gjebreas mora pjesë pas shumë vitesh mungese. Pas këtij prezantimi, mora pak kohë të punoj disa materiale të reja dhe kthehem në Shqipëri për të përfunduar projektet që nisa në vendin tim. Besoj se pas një eksperiencë të gjatë në muzikë, ka ardhur koha që unë të zbuloj punën dhe pasionin tim për notat muzikore.

Pr, ju do të riktheheni në Tiranë me surpriza në muzikë?

Në asnjë moment nuk i jam ndarë muzikës! Po punoj shumë që bashkëpunimet që kam bërë me producentët shqiptarë dhe ato amerikan të dalin në të njëjtën kohë. Që do të thotë se, projektet e mia muzikore do të marrin jetë nga bashkëpunimet me emra shumë të njohur të muzikës në Amerikë. Ndërsa, në Tiranë do të vij në fillim të nëntorit për të punuar një këngë me tekst të Rozana Radit dhe muzikë të Jurgen Shirës. Kënga

do të regjistrohet në anglisht.

Si nis dhe përfundon një ditë për Dorin në Amerikë?

Ditët e mia janë të zëna, pasi jam mamaja e dy djemve; Nick 13 vjeç dhe Alex 8 vjeç dhe bashkëshorte e një njeriu shumë të veçantë që më mbështet në çdo hap dhe të them të drejtën më shtyn që të punoj për të realizuar ëndrrat e mia. Kjo dashuri e ka emrin Xhuljan.

Ju jeni një nga pjesëtarët e girl band-it të parë shqiptar "Spirit Voice". Keni menduar një rikthim të grupit?

"Spirit Voice", ne gjithmonë e kemi thënë që nuk jemi ndarë, por jemi duke punuar për arritjet tona personale. Gjithmonë jemi në 'look out', për ndonjë material të përshtatshëm për grupin. Shpresoj që, shumë shpejt "Spirit Voice" do të ketë diçka konkrete për të gjithë fansat që nuk e kanë harruar grupin, por që na shkruajnë vazhdimisht dhe janë entuziast për projektet tona.

Sa ju ka munguar skena shqiptare dhe a keni menduar që ndonjë ditë të jeni prezent edhe në tregun botëror si këngëtare?

Skena shqiptare, dashuria ime e parë më mungon pa masë.

Unë jetoj në Amerikë dhe vazhdoj të këndoj në koncerte të ndryshme për komunitetin shqiptarë në Amerikë dhe Kanada, por atë emocion që të fal skena që më rriti profesionalisht nuk mund të ma fal asnjë skenë tjetër.

Prej kohësh po punoni dhe po provoni sërish për të depërtuar në tregun kaotik muzikor shqiptar me një tjetër publikim. Ku konsiston ky projekt muzikor?

Nuk jam larguar asnjëherë nga muzika, prej vitesh këngët e mia janë në iTunes. Gjë që tregon se së shpejti do të filloj të këndoj në skena Amerikane. Prandaj, ky pushim ka qenë si pjesë përgatitore për të depërtuar në MTV awards. Dua të theksoj se, nuk do ta harroj kurrë ngrohtësinë që kam ndjerë kur kam kënduar në Shqipëri. Kjo dashuri më bëri të jem e denjë për çdo lloj skene.



SYNIMI

Nuk jam larguar asnjëherë nga muzika, prej vitesh këngët e mia janë në iTunes. Gjë që tregon se së shpejti do të filloj të këndoj në skenat Amerikane

